



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 625 Akti

Nr. 795 Vendimi
Tiranë, më 4.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 3.9.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Tonin Sterkaj**, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, aktualisht me funksionin gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar – ish-DSIK (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, duke ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 15.7.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 15.7.2024 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë nr. *** prot., datë 4.4.2018.

² Raporti i AKSIK-së (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 3.1.2022.

paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 26.8.2024 (nëpërmjet rrugës elektronike me *email*, si dhe duke i depozituar në Komision, protokolluar me nr. ***).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi ta ftojë atë në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 28.8.2024.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 3.10.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Tonin Sterkaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë edhe interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të⁵.

23. Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj.

⁴ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁵ Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

23.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Pasuria e llojit tokë truall, me sipërfaqe 240 m², ndodhur në qytetin e Shkodrës (pasuria nr. ***, z. k. ***, volum ***, faqe ***), regjistruar në emër të bashkëshortes, znj. L.S , blerë në datën 20.2.2001, në vlerën 500,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij si gjyqtar.

24.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhura nga ZVRPP Shkodër.*

25. Pasuria e llojit shtëpi banimi, me sipërfaqe 123.3 m², ndërtuar në vitet 2002 – 2003, ndodhur në qytetin e Shkodrës (pasuria nr. ***, z. k. ***, volum ***, faqe ***), regjistruar në emër të bashkëshortes, znj. L.S , me vlerë 3,500,000 lekë – 4,000,000 lekë. Deklaron se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

25.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në ndërtimin e banesës është ndihmuar edhe nga të afërmit të tij, prindërit, vëllezërit dhe kunati. Referon se: (i) vëllai i tij, A.S (me shtetësi gjermane), që jeton në Gjermani që nga viti 1990, i ka dhuruar në fund të vitit 2002 shumën *cash* prej 6,000 euro; (ii) vëllai i tij, A.B (S), gjithashtu me shtetësi gjermane, që jeton në Gjermani prej vitit 1998, i ka dhuruar në fund të vitit 2002 shumën *cash* prej 4,000 euro; (iii) kunati i tij, i ndjeri N.L , i cili ka jetuar në Itali që nga viti 1999, i ka dhuruar po në fund të vitit 2002 shumën prej 2,000 euro.

25.2 Gjithashtu, subjekti ka evidentuar faktin se në datën 23.1.2004 kjo banesë i është djegur dhe se për rindërtimin e saj është ndihmuar nga shumë njerëz.

25.3 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: (i) *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (situacion/preventiv punimesh) lidhur me ndërtesën me sipërfaqe totale 394.51 m², lagjja “***”, Shkodër, deklaruar në vlerën rreth 3,500,000 lekë – 4,000,000 lekë. Gjithashtu, gjykohet se vlera e deklaruar prej 3,500,000 lekë – 4,000,000 lekë është e ulët, kjo referuar edhe formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, bashkëlidhur përgjigjes së ALUIZNI-t Shkodër, e cila ka llogaritur si vlerë investimi 11,038,784 lekë; (ii) Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e vëllezërve dhe kunatit në vlerën prej 12,000 euro, të cilat kanë shërbyer si burim për ndërtimin e banesës 3 kate, me sipërfaqe totale 394.51 m², Shkodër, vitet 2002 – 2003, deklaruar me vlerë rreth 4,000,000 lekë”.*

Deklarimi i këtyre pasurive në vite (trualli dhe shtëpia e banimit në Shkodër)

26. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë (e vitit 2003), në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to”, subjekti ka deklaruar se: (i) Zotëron 50% pjesë takuese të pasurisë së llojit shtëpi banimi me sip. 140 m², ndodhur në qytetin e Shkodrës, me vlerë 3.5 milionë lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar se është ndërtuar nga kursimet, si dhe ndihmat (dhuratat) që i kanë dhënë vëllezërit, për të cilët referon se tre prej tyre jetojnë në Gjermani dhe dy të tjerë në Itali, si dhe motra e bashkëshortes së tij që jeton në Itali. Deklaron se dërgesat janë bërë nëpërmjet Western Union; (ii) Zotëron 50% pjesë takuese të pasurisë së llojit truall me sip. 240 m², ku është ndërtuar shtëpia e banimit, blerë nga bashkëshortja e tij rreth vitit 2000 apo 2001, me vlerë 0.5 milion lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie duket se ka deklaruar kursimet e tij.

27. Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit shtëpi banimi të ndërtuar në vitin 2003, deklaruar në vitin 2004, regjistruar në ZVRPP-në Shkodër në datën 19.7.2013, në emër të bashkëshortes, znj. L.S .

28. I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁶ lidhur me këtë pasuri (shtëpia e banimit), subjekti ka deklaruar se e ka filluar ndërtimin e saj në qershor të vitit 2002 dhe e ka përfunduar në vitin 2003. Sa i përket burimit të krijimit, ka deklaruar se kjo banesë është ndërtuar me kursimet ndër vite dhe ndihma e familjarëve emigrantë në shtete të ndryshme të Europës, nga ku referon se tre vëllezër i ka me nënshitetesi gjermane, dy vëllezër dhe një motër banojnë në Itali, një motër në Kanada, si dhe motra e bashkëshortes me banim në Itali. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në ndërtimin e banesës ka kontribuar edhe babai i tij, i cili kishte punuar më parë në ndërtim.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni mbi mënyrën e krijimit të këtyre pasurive, si dhe për të ardhurat të cilat janë deklaruar si burime financiare të krijimit të tyre

29. Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe atij të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këto pasuri⁷, Komisioni konstaton se:

29.1 Në datën 20.2.2001 është lidhur kontrata e shitblerjes⁸ së pasurisë së paluajtshme sipërfaqe trualli e lirë midis shtetasve L.P.S (bashkëshortja e subjektit) – në cilësinë e palës blerëse dhe shtetasve N.M, A, Gj dhe K. L – në cilësinë e palës shitëse, me objekt “Shitjen e një trualli me sipërfaqe 240 m², të ndodhur në lagjen “***”, Shkodër, kundrejt çmimit 500,000 lekë”.

29.2 Rezulton se në datën 26.2.2001, në regjistrat hipotekorë është regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. L.S , pasuria e llojit truall me nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 240 m². Komisioni konstaton se në seksionin “Përshkrim i veçantë” të kartelës së kësaj pasurie referohet lloji i pasurisë truall, ndërsa në seksionin “Shënime dhe shuma e paguar” referohet kontrata e shitblerjes datë 20.2.2001, si dhe çmimi i paguar prej 500,000 lekësh.

30. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për blerjen e truallit mbi të cilën është ndërtuar banesa 3-katëshe, për periudhën 1.8.1995 – 20.2.2001, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për blerjen e truallit me sipërfaqe 240 m², të ndodhur në qytetin e Shkodrës. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën rreth 200,000 lekë. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

⁶ Referojuni dokumentit “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, i datës 22.10.2014, dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024.

⁷ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) shkresa e ZQRPP nr. *** prot., datë 4.10.2017; shkresa e ZVRPP Shkodër nr. *** prot., datë 22.9.2017; Shkresa e ALUIZNI-t nr. *** prot., datë 28.7.2017; shkresa e ALUZINI-t nr. *** prot., datë 8.8.2017; shkresa e ALUIZNI-t nr. *** prot., datë 22.8.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (të ndodhura në aneks nr. ***, ***, *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së); (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr *** prot., datë 5.2.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.2.2024); (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁸ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2001, redaktuar nga noteri publik, z. A.K .

31. Në vijim, rezulton se në datën 7.9.2006, nëpërmjet formularit “Vetëdeklarim për legalizimin”, dorëzuar Njesisë së Urbanistikës së Njesisë së Qeverisjes Vendore Shkodër, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar objektin shtëpi banimi të ndërtuar në datën 1.3.2003, me sipërfaqe të zënë 240 m², sipërfaqe ndërtimi 123.7 m², numri i kateve mbi tokë 3.

32. Në datën 4.5.2009, nga ALUZINI është vlerësuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për këtë pasuri, duke u përlogaritur vlera e ndërtimit $394,51 \text{ m}^2 \times 27,981 \text{ lekë/m}^2 = 11,038,784 \text{ lekë}$. Komisioni konstaton se në vitet 2009 dhe 2013 personi i lidhur, znj. L.S , ka kryer pagesat e tarifave për legalizimin e këtij objekti, në total në vlerën 128,387 lekë.

33. Në datën 7.12.2012, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Shkodër, ka bërë aktin e kualifikimit të kësaj godine, sipas të cilit rezulton se objekti informal ka sipërfaqe 240 m² parcelë ndërtimore, sipërfaqe të bazës së objektit 123.3 m², numër katesh 3 kate.

34. Në datën 21.1.2013 është lëshuar leja e legalizimit në emër të personit të lidhur për këtë pasuri, objektin godinë banimi 3 kate, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 240 m², sipërfaqe ndërtimi 123.3 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtimit 394.51 m².

35. Po në datën 21.1.2013 rezulton se kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të bashkëshortes së subjektit. Referuar kartelës së pasurisë, godina 3-katëshe ka këto të dhëna: (i) kati përdhe me sipërfaqe 123.3 m²; (ii) kati i parë me sipërfaqe 128.55 m²; (iii) kati i dytë me sipërfaqe 142.66 m². Sipërfaqja totale e ndërtimit 394.51 m².

36. Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar të dhëna të plota dhe nuk e përshkruar saktësisht atë – konkretisht duke mos pasqyruar sipërfaqen totale të ndërtimit, sipërfaqen e ndërtimit për çdo kat dhe ecurinë e punimeve për ndërtimin e këtij objekti, si dhe duke mos specifikuar në mënyrë kronologjike shpenzimet e kryera dhe burimin e krijimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer në vazhdimësi për ndërtimin e plotë të tij. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi këtë konstatim.

36.1 Me dërgimin e prapësimeve, ndër të tjera, në lidhje me godinën e banimit, subjekti ka parashtruar se në deklaramin e bërë ka referuar të dhënat e pasurisë sipas dokumentit të pronësisë të lëshuar nga Zyra Hipotekore Shkodër.

36.2 Komisioni vëren se me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka depozituar praktikën e legalizimit të godinës së banimit objekt vlerësimi, ku nga verifikimi i dokumentacionit evidentohen të dhëna të plota të kësaj pasurie, mbi sipërfaqen ndërtimore, numrin e kateve dhe sipërfaqen për çdo kat. Në këtë kontekst, në kushtet kur deklarimi i bërë është shoqëruar me dokumentacionin përkatës me të dhënat e plota të kësaj pasurie, pasaktësia e konstatuar vlerësohet se nuk ndikon në procesin e rivlerësimit për këtë subjekt.

36.3 Ndërsa, sa i përket shpenzimeve totale të kryera për këtë objekt, specifikimit të tyre në mënyrë kronologjike dhe evidentimin e burimit konkret të të ardhurave të cilat kanë shërbyer në vazhdimësi për ndërtimin e këtij objekti, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka parashtruar pretendimet e tij në lidhje me vlerën totale të shpenzuar, periudhën e ndërtimit dhe burimin e të ardhurave, të cilat Komisioni do t’i trajtojë në vlerësimin e mundësisë financiare për kryerjen e këtij investimi.

37. I pyetur nga Komisioni⁹ për adresat e banimit dhe shpenzimet e kryera që nga marrja e detyrës për vlerat mbi 2,500 euro (pyetëtori nr. ***), ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ndërtimi i pasurisë objekt vlerësimi është kryer në periudhën 2002 – 2003 dhe se ka filluar të banojë në këtë godinë prej muajit mars të vitit 2003. Sa i përket vlerës së investimit, deklaroi se ka qenë rreth 3,500,000 lekë – 4,000,000 lekë.

38. Ndërsa, në përgjigje të pyetëtorit nr. ***¹⁰, subjekti ka deklaruar se deri në mars të vitit 2003 ka pasur të përfunduar vetëm karabinanë, çatinë, kuzhinën, dhomën e fjetjes së fëmijëve, dhomën e fjetjes së tij me bashkëshorten dhe një tualet. Referon se në këto pjesë të banesës kishin përfunduar instalimet elektrike e hidraulike, ndërsa pjesët e tjera të banesës nuk kishin përfunduar. Gjithashtu, deklaroi se duke filluar nga janari i vitit 2004 (pas djegies) e në vijim ka rifilluar e përfunduar së ndërtuari banesën. Ka shpjeguar se edhe sot banesa është si në vitin 2004, siç ka qenë kur është rindërtuar pas djegies, ku kati përdhe, apo ndryshe bodrumi, ende nuk është përshtatur tërësisht për banim.

39. Pasi iu kërkua të paraqesë në mënyrë kronologjike shpenzimet/investimet e kryera në lidhje me ndërtimin e kësaj godine, subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar rreth 2,000,000 lekë për materialet e ndërtimit në periudhën qershor 2002 – shkurt 2003 dhe se punimet janë kryer pa pagesë nga persona të tij të afërt, të cilët kanë punuar në fushën e ndërtimit.

39.1 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion në lidhje me ndërtimin e kësaj pasurie, si projekt e ndërtimi/preventiv punimesh/situacione punimesh/fatura tatimore apo çdo lloj dokumentacioni tjetër.

40. Komisioni kreu verifikime në geoportalin “ASIG”, me qëllim evidentimin e fazave të ndërtimit të kësaj pasurie. Nga një foto e vitit 2001 evidentohet parcela/trualli mbi të cilën është ngritur kjo ndërtesë, por duket se nuk ka shenjë të ndërtimit. Ndërsa, nga pamjet e përfituara nga *Google Earth Pro* duket se në maj të vitit 2003 ka qenë ndërtuar dhe përfunduar edhe pjesa e çatisë së këtij objekti 3-katësh.

41. Për sa më sipër, referuar dokumentacionit shkresor të administruar në dosjen e hetimit, pamjeve të marra nga burime të hapura, si dhe bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, Komisioni arrin në përfundim se pasuria objekt vlerësimi është ndërtuar në vitet 2002 – 2003.

42. Nga ana tjetër, në kushtet kur kemi të bëjmë me një ndërtim informal, si dhe në mungesë të të dhënave të sakta për fazat e investimit të kryera mbi këtë pasuri, referuar vetëdeklarimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, formularit të vetëdeklarimit të depozituar te ALUZNI, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, rezulton se ndërtimi i godinës ka qenë i përfunduar në vitin 2003.

43. Bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 16.10.2002, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K”¹¹, duket se kostoja mesatare e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë për vitin 2002 ka qenë në vlerën 29,835 lekë/m². Ndërsa, bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave

⁹ Pyetëtori nr. ***, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹⁰ Pyetëtori nr. *** dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹¹ <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/08/2002.pdf>

në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K”¹², duket se kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës për vitin 2003 ka qenë në vlerën 25,414 lekë/m².

43.1 Në këto rrethana, në kushtet kur duket se ndërtimi i këtij objekti është realizuar përgjatë viteve 2002 – 2003, si dhe nisur nga fakti se kostoja mesatare e ndërtimit e përcaktuar për qytetin e Shkodrës në udhëzimin e EKB-së për vitin 2003 është më e vogël se kostoja mesatare e ndërtimit e përcaktuar për të gjithë territorin e Shqipërisë për vitin 2002, Komisioni do të përlllogarisë si kosto mesatare të ndërtimit për objektin e ndërtuar nga subjekti i rivlerësimit koston e pasqyruar në udhëzimin e dalë për EKB-në të vitit 2003, ku specifikohet kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës, 25,414 lekë/m².

44. Sa më sipër, për efekt të analizës financiare, do të vlerësohet se deri në fund të vitit 2003 vlera e investimit të kryer në ndërtimin e kësaj godine me sipërfaqe totale ndërtimore 394.5 m² duket se ka qenë 10,025,823 lekë (sipërfaqja totale 394.5 m² e shumëzuar me koston mesatare të ndërtimit për 25,414 lekë = 10,025,823 lekë).

45. Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se për ndërtimin e kësaj banese kanë shërbyer edhe të ardhurat e dhuruara nga: (i) vëllai i tij, A.S, në shumën 6,000 euro; (ii) vëllai i tij, A.B (S), në shumën 4,000 euro; (iii) kunati i tij (bashkëshorti i motrës), N.L , në shumën 2,000 euro. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se në përputhje me pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, këta shtetas kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët, pasi pranojnë dhurimin e kryer, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, e në këtë rast burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të deklaruara si të dhuruara në favor subjektit të rivlerësimit në vitin 2002.

45.1 Sa i përket shtetasit A.S , Komisioni konstaton se ai ka pranuar dhurimin e kryer në favor të subjektit, nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 3.11.2014¹³, duke referuar se në fund të vitit 2002 i ka dhuruar *cash* subjektit të rivlerësimit shumën 6,000 euro, me qëllim ndërtimin e shtëpisë së banimit. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, duket se ky shtetas ka qenë në marrëdhënie pune në shtetin gjerman pa ndërprerje prej vitit 1994 e në vijim, por se gjatë hetimit administrativ nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e përfituara nga ky shtetas prej marrëdhënies së tij të punës dhe mbi pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, të paktën deri në fund të vitit 2002.

45.2 Sa i përket shtetasit A.B (S), subjekti ka depozituar një deklaratë që mban datën 12.11.2014, në referim të së cilës ai ka konfirmuar dhurimin e shumës 4,000 euro në fund të vitit 2002. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, nuk evidentohen të dhëna mbi të ardhurat e përfituara nga ky shtetas dhe për pagesën e detyrimeve tatimore mbi to, deri në fund të vitit 2002.

45.3 Sa i përket shtetasit N.L , rezulton se gjatë hetimit administrativ nuk është paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, nëpërmjet të cilit ky shtetas të ketë pranuar dhurimin e kryer në favor të subjektit, si dhe mbi të ardhurat e përfituara prej tij, të cilat pretendohen se kanë shërbyer për dhurimin e kryer. Subjekti ka pretenduar pamundësi për disponimin e këtij dokumentacioni, për shkak se deklaroi se pala dhuruese ka ndërruar jetë në vitin 2011.

¹² <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/08/2003.pdf>

¹³ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. O. K .

46. Gjithashtu, duket se subjekti nuk ka dokumentuar mënyrën e përfitimit të këtyre shumave të dhuruara¹⁴ – sipas vetëdeklarimit të bërë. Për më tepër, duket se ka mospërputhje mes deklarimeve të tij dhe të një prej palëve dhuruese, pasi në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë (e vitit 2003), subjekti ka deklaruar se këto ndihma/dhurata i janë dërguar nëpërmjet institucionit financiar Western Union, ndërsa në deklaratën noteriale të vitit 2014 vëllai i tij, A.S , ka deklaruar se ia ka dhënë *cash* shumën prej 6,000 euro në fund të vitit 2002.

47. Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion të plotë justifikues ligjor për të provuar marrëdhënien e dhurimit me personat e tjerë të lidhur, të ardhurat e përfituara prej tyre – të pretenduara dhe deklaruara si burim i shumave të dhuruara, si dhe mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këto konstatime.

48. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 1.8.1995 – 31.12.2003, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen e investimit në pasurinë objekt vlerësimi, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer në ndërtimin e shtëpisë së banimit 3-katëshe (përfshirë këtu edhe blerjen e truallit), si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara/evidentuara për periudhën 1.8.1995 – 31.12.2003. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 10.2 milionë lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi rezultatin financiar për periudhën objekt analize.

49. Gjithashtu, rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka evidentuar faktin se në datën 23.1.2004 kjo banesë i është djegur dhe se për rindërtimin e saj është ndihmuar nga shumë njerëz. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2004, regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 23.1.2004, ku rezulton se kishte marrë flakë banesa e tij.

50. Komisioni administroi dosjen e plotë të këtij procedimi penal¹⁵. Referuar aktit të ekspertimit të mbajtur në lidhje me këtë procedim penal, si dhe tabelës fotografike përkatëse, duket se dëmi i shkaktuar është djegia e katit të tretë të ndërtesës dhe e një pjese të çatisë.

51. Pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë mbi burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për rindërtimin e kësaj banese pas djegies së saj – duke evidentuar edhe individët të cilët pretendon se e kanë ndihmuar për rindërtimin, nëse këto shuma të dhëna prej tyre kanë qenë në formë huaje/dhurimi/ndihme financiare apo tjetër, si dhe vlerën përkatëse të dhënë nga çdo individ dhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e këtyre shumave të pretenduara si të dhëna në favorin e tij¹⁶, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se *vlera e dëmit nuk mund të përcaktohet prej tij, por se dëmet ka qenë të konsiderueshme... Për rindërtimin e banesës është ndihmuar nga shumë njerëz (familjarë të tij e të bashkëshortes që jetojnë brenda e jashtë shteti,*

¹⁴ Ka depozituar shkresën e Unionit Financiar nr. *** prot., datë 23.5.2024, në referim të së cilës evidentohet se ky institucion disponon të dhëna deri në 5 vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare.

¹⁵ Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me nr. *** prot., datë 22.5.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.5.2024).

¹⁶ Pyetja nr. 1 e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

të afërm, kolegë të punës, të njohur, miq, shokë, fond i veçantë nga Gjykata. Në dijeninë e tij kanë pasur ndihma në vlerë monetare që i janë dërguar nëpërmjet shërbimit Western Union nga të afërm të tij e të bashkëshortes). Thekson se nga këto ndihma i është dhuruar një shumë e konsiderueshme vlerash monetare (si lek, euro, dollar), që ia kanë bërë shumë të lehtë rindërtimin e banesës pas djegies.

51.1 Në vijim, deklaroi se për vetë situatën psikologjike në të cilën ndodheshim, si dhe referuar të drejtës zakonore e traditës, as nuk kanë kërkuar e as nuk kanë mbajtur shënime në lidhje me këto ndihma. Referon se i kanë ofruar ndihmë, i kanë bërë dhurata, por asnjëherë nuk i kanë dhënë hua dhe se ndihma ka qenë pa interes.

52. Referuar marrëveshjes së datës 17.5.2006, “Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”, në tabelën nr. 3 të saj, ndër të tjera, përcaktohet volumni që zënë zërat e punimeve, si vijon: (i) gërmimet me makineri zënë 0.3% të volumnit të punimeve; (ii) struktura betonarme zë 36.4% të volumnit të punimeve; (iii) vendosje hekur betoni zë 7.7% të volumnit të punimeve. Pra, duket se në total këto punime zënë 44.4% të volumnit të punimeve dhe vlerës së ndërtimit të objektit, të cilat Komisioni vlerëson se nuk duhet të konsiderohen si punime të kryera për rindërtimin e katit të fundit të godinës 3-katëshe pas shkatërrimit nga zjarri i ndodhur në vitin 2004.

52.1 Si rrjedhim, Komisioni paraprakisht vlerëson se për sipërfaqen e ndërtimit prej 142.66 m² (kati i tretë i ndërtimit), referuar vlerës për koston mesatare të ndërtimit për metër katror në qytetin e Shkodrës për vitin 2004 (udhëzimi nr. 1, datë 4.3.2004, i EKB-së) dhe volumnit të punimeve të vlerësuara si të kryera për rindërtim, vlera e investuar vetëm për punimet e rifiniturave dhe për riparimin e vendosjen e çatisë (pa përfshirë 44.4% të punimeve) duket se është në shumën 1,958,464 lekë (142.66 m² x 24,691 lekë/sipërfaqe ndërtimi x 55.6%). Për sa më sipër, kjo vlerë është përlllogaritur në analizën financiare paraprake si shpenzim i kryer nga subjekti dhe personi i lidhur për rindërtimin e banesës në vitin 2004.

53. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për vitin 2004, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e rindërtimit të katit të tretë të godinës së banimit dhe çatisë – pas djegies – nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer për rindërtimin e katit të fundit të shtëpisë së banimit 3-katëshe, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara/evidentuara për vitin 2004. U evidentua balanca e negative e fondeve në shumën prej rreth 1.6 milionë lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi rezultatin financiar për periudhën objekt analize.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

54. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me pasuritë objekt vlerësimi – duke parashtruar sa më poshtë vijon:

54.1 *Së pari*, subjekti kërkon që në analizën financiare të përfshihen edhe të ardhurat e përfituara prej tij para fillimit të detyrës si gjyqtar. Kështu, subjekti ka paraqitur dokumentacionin me të dhënat e punësimit të tij për periudhën 1986 – korrik 1995.

54.2 *Së dyti*, subjekti ka pretenduar se për periudhën objekt analize, para vitit 1995, ka përfituar të ardhura të konsiderueshme nga ushtrimi i aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, duke referuar se së bashku me të ardhurat e tjera nga pagat të ardhurat totale për periudhën 1986 – 31.12.1994 kanë qenë në shumën prej rreth 2,400,000 lekësh.

54.3 *Së treti*, ka kërkuar që të reduktohen shpenzimet minimale jetike për periudhën objekt analize sipas aktit të ekspertimit nga shoqëria “****” sh.p.k., prej audituesit ligjor, z. E. K¹⁷.

54.4 *Së katërti*, subjekti ka kundërshtuar vlerën e përllogaritur nga Komisioni në lidhje me ndërtimin e objektit të banimit në Shkodër, duke pretenduar se nga kjo vlerë duhen zbritur zërat “punëtori”, “transport” e “makineri”, të cilat referon se së bashku zënë 46.9% të kostos për metër katror dhe se janë kryer/mbuluar prej tij dhe të afërmeve, si dhe shpenzimet plotësuese dhe fitimi që zënë së bashku 18% të kostos për metër katror. Pra, në total kërkon të zbritet 64.9% e kostos së përllogaritur nga Komisioni¹⁸.

54.5 *Së pesti*, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihen shumat e deklaruara prej tij si të dhuruara nga vëllezërit dhe kunati – të referuara si burim konkret i krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, godinës së banimit në Shkodër, duke depozituar dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij.

54.6 *Së fundmi*, subjekti ka kundërshtuar edhe vlerën e përllogaritur nga Komisioni për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë, duke pretenduar se ajo ka qenë në shumën 707,287 lekë, sipas aktit të ekspertimit kontabël, ndërsa sipas aktit të ekspertimit të inxhinierit në shumën 320,000 lekë. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar deklarimeve të mëparshme se për rindërtimin e katit të djegur të banesës është ndihmuar me vlera monetare nga shumë njerëz, miq, kolegë e të afërm, por duke mos përcaktuar shumën konkrete. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se bazuar edhe në aktin e ekspertimit kontabël ai ka pasur gjendje *cash* të mbartur në vitin 2004, vlerë e cila është përdorur si burim për rindërtimin e katit të djegur të banesës.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

55. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton si vijon:

55.1 Në lidhje me pretendimet e ngritura për reflektimin e të ardhurave shtesë e, në këtë kontekst, të shtirjes së periudhës objekt analize, Komisioni vlerësoi të pranojë pjesërisht pretendimet e tij, duke çmuar që në një qasje garantiste të përllogarisë të ardhura shtesë të përfituara prej tij për periudhën 1993 – korrik 1995, në shumën 189,000 lekë – kjo bazuar në vetëdeklarimet e bëra dhe indiciet e përfituara nga provat e reja të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve, të cilat referojnë të dhëna të punësimit të tij për këtë periudhë. Por, nga ana tjetër, bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit për këtë periudhë – ashtu sikurse ishte vlerësuar edhe në analizën e mëparshme për periudhën deri në vitin 1999 – do të vlerësohet se 66% e të ardhurave kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve¹⁹. Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson se janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit sa i përket

¹⁷ Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar raportin e audituesit ligjor, z. E.K, datë 17.8.2024.

¹⁸ Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentin situacion punimesh të punuar nga ing. F.E.

¹⁹ Referojuni vendimit të Kolegjit nr. 10/2019 (JR).

reduktimit të shpenzimeve jetike për periudhën objekt analize, duke evidentuar edhe një herë se deri në vitin 1999 janë vlerësuar sa 66% e të ardhurave dhe se pas vitit 1999, sipas metodologjisë së ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it.

55.2 Sa i përket pretendimeve të subjektit në lidhje me të ardhurat shtesë të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit bujqësor e blegtoral, Komisioni vëren se nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor.

55.3 Në vijim të vlerësimit të prapësimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni arrin në përfundimin se ai ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e përfituara nga dhuruesi A.S , të cilat vlerësohen se janë të mjaftueshme për të mundësuar dhënien prej tij të shumës 6,000 euro. Ndërsa, për personat e tjerë të lidhur, A.S dhe N.L , konkludohet se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin prej tyre të të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shumave të referuara si të dhuruara e, në këtë kontekst, shumat e pretenduara prej 4,000 euro dhe 2,000 euro nuk do të përfshihen në analizën përfundimtare financiare.

55.4 Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti sa i përket vlerës së ndërtimit të këtij objekti dhe rindërtimit të katit të tretë dhe çatisë, në këndvështrim të faktit se ndërtimi i këtij objekti, por edhe punimet e kryera për rindërtimin e shtesës, janë kryer në mënyrë informale, pra jo nga subjekte të licencuara dhe të regjistruara në organin tatimor, po t'i zbresim vlerës së përlllogaritur për ndërtimin dhe rindërtimin shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH + fitim + fond rezervë – vlera këto të përfshira në përlllogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit (pra rreth 35% të saj)²⁰, shpenzimet e realizuara për ndërtimin e godinës së banimit objekt vlerësimi deri në vitin 2003 vlerësohen përfundimisht në shumën 6,516,785 lekë, ndërsa për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në shumën 1,273,002 lekë.

55.5 Edhe sa i përket deklarimeve në lidhje me ndihma financiare të marra nga miq, kolegë apo të afërm të tij për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë së godinës së banimit në Shkodër, Komisioni vëren se subjekti ka referuar disa shtetas, të cilët pretendon se e kanë ndihmuar me vlera monetare, por se gjithsesi nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor nëpërmjet të cilit këta shtetas, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, të pranonin dhurimin e kryer, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion mbi ligjshmërinë e ardhurave të tyre, për të provuar shumat potenciale si ndihmë financiare/dhurim të dhënë në favor të subjektit.

55.6 Gjithashtu, Komisioni gjen të pabazuar pretendimin e subjektit se në fund të vitit 2003 ka pasur kursime në gjendje *cash* me burim të ardhurat e përfituara përgjatë viteve, kjo për sa kohë nuk rezulton të ketë deklaruar likuiditete *cash* në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklaram të vitit 2003.

56. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për blerjen e truallit, investimin e kryer në ndërtimin e godinës së banimit, si dhe për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë pas djegies, të pasqyruar në tabelat si më poshtë:

²⁰ Referojuni paragrafit nr. 37 të vendimit të Kolegjit nr. 15/2019 (JR).

Tabela nr. 1

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1993 – 31.12.2003	Vlerat në lek
A) Pasuri	7,016,785
Tokë truall në qytetin e Shkodrës	500,000
Shtëpi banimi 3 kate në qytetin e Shkodrës	6,516,785
Ndryshim likuiditeti	0
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	7,016,785
D) Të ardhura	4,203,111
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	3,258,111
Të ardhura nga dhurimi i shtetasit A.S	756,000
Të ardhura nga punësimi i subjektit para marrjes së detyrës si gjyqtar	189,000
E) Shpenzime	3,050,375
Shpenzime minimale jetike	3,014,375
Shpenzime qiraje	36,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-5,864,049

Tabela nr. 2

Analiza e treguesve financiarë për vitin 2004	Vlerat në lek
A) Pasuri	1,273,002
Shtëpi banimi 3 kate në Shkodër (punime për rindërtim kati)	1,273,002
Ndryshim likuiditeti	0
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1,273,002
D) Të ardhura	874,489
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit (përfshirë ndihma nga fondi i veçantë)	874,489
E) Shpenzime	549,320
Shpenzime minimale jetike	469,320
Shpenzime arredimi/mobilimi	80,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-947,833

57. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar plotësisht blerjen e truallit në vitin 2001, ndërtimin e godinës së banimit në vitet 2002 – 2003, si dhe rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

58. **Pasuria automjet tip “****”,** prodhim i vitit 2005, blerë në Gjermani në datën 25.3.2009, me vlerë 12,700 euro, aktualisht targuar AA ***.

58.1 Subjekti ka referuar se të ardhurat për të blerë këtë automjet i ka marrë hua, e konkretisht shtetasve Gj.M (kontratë noteriale huaje datë 1.4.2009) dhe A.N.S (kontratë noteriale huaje datë 30.3.2008). Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se huaja ndaj shtetasit Gj.M ka mbetur e pashlyer, ndërsa huan ndaj shtetasit A.S e ka shlyer në korrik të vitit 2015 (referon kontratën noteriale të datës 11.7.2015) me të ardhurat e siguruara nga kursimet e tij prej punës si gjyqtar dhe shitja e 1,892 kg sherebelë të prodhuar në tokën në fshatin D, Malësi e Madhe.

58.2 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Dokumentacion jo i plotë ligjor lidhur me të ardhurat e shtetasve Gj.M dhe A. S, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për blerjen e automjetit tip “****” në vitin 2009, në vlerën 12,700 euro.* Gjithashtu, mbetet e paqartë lidhja e subjektit me shtetasin Gj.M dhe fakti që detyrimi ndaj tij nuk është shlyer ende.

58.3 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “****”, me targë SH ***, me vlerë 12,700 euro. Ndërsa, në seksionin e deklarimit të detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: (i) huan e marrë shtetasit Gj.M, në shumën 1,400,000 lekë, duke referuar kontratën noteriale të huas datë 1.4.2009 (hua pa interes, me afat shlyerjeje 7 vjet); (ii) huan e marrë shtetasit A.N.S, në shumën 800,000 lekë, duke referuar kontratën noteriale të huas datë 30.3.2009 (hua pa interes, me afat shlyerjeje 6 vjet). Për të dyja këto hua nuk ka deklaruar vlera të shlyera përgjatë vitit 2009.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

59. DPSHTRR-ja²¹ informon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA *** (me targë të mëparshme SH ***). Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja konfirmohet se në datën 25.3.2009 subjekti i rivlerësimit ka blerë²² në qytetin Homburg, Gjermani, pasurinë automjet tip “****”, prodhim i vitit 2005, për çmimin 12,700 euro. Duket se në datën 4.4.2009 subjekti ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, duke paguar detyrimin doganor, në total në shumën 446,306 lekë.

60. Komisioni konstatoi se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2009 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në shumën 12,700 euro, por nuk ka referuar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, rezulton se në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar dy huat e marra nga shtetasit Gj.M dhe A.S – duke referuar edhe kontratat respektive – por pa referuar qëllimin e marrjes së tyre. Sipas deklarimit të bërë dhe kontratave të huave të administruara në dosjen e hetimit, shtetasit Gj.M i ka marrë hua shumën prej 1,400,000 lekësh, pa interes, dhe me afat shlyerjeje prej 7 vjetësh, ndërsa shtetasit A.S shumën prej 800,000 lekësh, pa interes, dhe me afat shlyerjeje prej 6 vjetësh.

60.1 Nga ana tjetër, rezulton se në DIPP-në e viteve 2010 – 2014, në seksionin e deklarimit të detyrimeve financiare, në referimin e këtyre huave subjekti ka evidentuar se qëllimi i tyre ka qenë për arsye shëndetësore (shuma 1,400,000 lekë) dhe për nevoja familjare (shuma 800,000 lekë).

60.2 Në deklaratimet e dhëna gjatë hetimit administrativ (në përgjigje të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni), subjekti ka shpjeguar se dy huat e sipërcituara janë marrë me qëllim për mbulimin e shpenzimeve mjekësore, të cilat do të kryheshin prej tij në shtetin gjerman. Në vijim referon se nuk pranoi të bënte ndërhyrjen kirurgjikale mjekësore të rekomanduar nga mjekët gjermanë dhe se këto vlera të marra hua, pasi më parë i kishte konvertuar në euro, i përdori për blerjen e automjetit tip “****” në shtetin gjerman.

61. Sa më sipër, duket se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit mbi destinacionin e vlerave monetare të deklaruara si të marra hua në vitin 2009.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e DPSHTRR-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.2.2021).

²² Akt shitjeje datë 25.3.2009, shkresë e thjeshtë e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja R. P, me vërtetim nënshkrimi nga noteri publik, znj. I.H, nr. *** rep., datë 3.4.2009.

62. Pasi Komisioni i kërkoi subjektit²³: (i) të deklarojë mbi lidhjen/marrëdhënien e tij me huadhënësit: (ii) të konfirmojë qëllimin/arsyen e marrjes së këtyre huave: (iii) të japë sqarime mbi moskthimin në kohë të huas ndaj shtetasit Gj.M , sipas afateve të përcaktuara në kontratën e huas; (iv) të japë sqarime mbi mospërputhjet e evidentuara në deklaratimet e bëra mbi qëllimin e marrjes së këtyre huave; (v) të deklarojë duke konfirmuar nëse huadhënësit e kishin të qartë qëllimin e dhënies së këtyre vlerave monetare e, në këtë kuptim, nëse prej tij është marrë dakordësia e huadhënësve për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të këtyre shumave të marra hua etj. – subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtuar se:

62.1 *Shtetasin A.N.S e ka kushëri, ndërsa shtetasin Gj. Ll.M e njeh që në fëmijëri, pasi janë nga e njëjta zonë (Malësi e Madhe), ka marrëdhënie miqësore me të dhe se ky shtetas është nuni i djalit të tij, K.S... Në vijim, sqaron se borxhin ia ka marrë të lartpërmendurve personalisht e jo subjekteve që ata mund të përfaqësojnë, pasi ka menduar se kanë të ardhura të mjaftueshme financiare për ta ndihmuar. Në lidhje me faktin se pse nuk i është kthyer kjo hua shtetasit Gj.M sipas afateve të përcaktuara në kontratë, subjekti ka deklaruar se kjo ka ardhur për shkaqe shëndetësore të lidhura me nënën e tij, e ndjera T.S,... me mirëkuptimin edhe të huadhënësit...*

62.2 *Më tej, subjekti ka deklaruar se në fakt qëllimi për marrjen e borxhit ka qenë për arsye shëndetësore të tij të hershme e të vazhdueshme nga viti 1978... Për arsye shëndetësore (në datën 23.3.2009) ka shkuar në Gjermani me synimin që të bëjë ndërhyrjen kirurgjikale në shtyllën kurrizore i shoqëruar nga vëllai i tij A.S dhe nga bashkëshortja L.S , duke marrë me vete një pjesë nga kjo shumë e marrë hua (2,200,000 lekë), konkretisht shumen prej 1,800,000 lekësh të konvertuar në euro (rreth 13,000 euro). Por, pasi ka kryer vizitën mjekësore, për arsye objektive, ai nuk e ka kryer ndërhyrjen kirurgjikale...*

62.3 *Pasi ai ka anuluar ndërhyrjen kirurgjikale, meqenëse nuk kishte mjet në pronësi, me paratë e marra borxh ka blerë kundrejt çmimit 12,700 euro (në datën 25.3.2009) mjetin e llojit autoveturë të markës “***”...Deklaron se huadhënësit e kanë pasur të qartë qëllimin e dhënies së këtyre vlerave monetare, duke besuar në integritetin moral e personal të familjes së tij. Afati i shlyerjes së borxhit është lënë i gjatë, pasi për shkak të gjendjes shëndetësore nuk kishte siguri nëse do ta shlyente vetë apo do ia linte si detyrim familjarëve të tij e më pas me huadhënësit ka pasur kontakte, ka biseduar me ta dhe prej tyre ka gjetur dakordësinë për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumave të marra hua dhe mirëkuptimin e tyre për shtyrjen e afatit për kthimin e borxhit...*

63. Rezulton se nëpërmjet kontratës së huas datë 30.3.2009²⁴, shtetasi A.S , në cilësinë e huadhënësit dhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit, deklarojnë se janë marrë vesh jashtë zyrës noteriale që huadhënësi, A.S , i ka dhënë Tonin Sterkaj shumën 800,000 lekë, në datën 22.3.2009, për një afat 6-vjeçar, pa interes dhe se kjo shumë e dhënë hua do të kthehet në mënyrë pjesore e ndarë në gjashtë këste, e cila do të likuidohet në fund të çdo viti në muajin dhjetor dhe kësti i fundit do të likuidohet në datën 22.3.2015.

²³ Nëpërmjet pyetësorit nr. ***, të dërguar gjatë hetimit administrativ.

²⁴ Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2009, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

63.1 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, rezulton se për vitet 2009 – 2014 subjekti nuk ka deklaruar shlyerje të kësteve të kësaj huaje. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar shlyerjen e plotë të vlerës së kësaj huaje, në shumën totale 800,000 lekë²⁵.

64. Nëpërmjet kontratës së huas datë 1.4.2009²⁶, shtetasi Gj.M, në cilësinë e huadhënësit dhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit, deklarojnë se *në datën 21.3.2009, huadhënësi i ka dhënë huamarrësit vlerën prej 1,400,000 lekësh, i cili e merr këtë shumë për nevojat e tij. Gjithashtu, në këtë kontratë përcaktohet se afati i huas është 7 vjet, nga data 21.3.2009 deri më 21.3.2016, dhe se huamarrësi nuk do të paguajë interes për gjithë kohën e vonesës së kthimit të kësaj shume të marrë hua.*

64.1 Siç u evidentua më sipër, subjekti nuk e ka kthyer këtë hua brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Referuar deklarimeve të bëra nga subjekti në ILDKPKI²⁷ dhe pas verifikimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit, duket se kjo hua është shlyer plotësisht nëpërmjet dy transfertave bankare të kryera në mars dhe dhjetor të vitit 2018.

65. Për sa më sipër, nisur nga faktet dhe rrethanat se: (i) kontratat e huas janë bërë disa ditë pasi subjekti është kthyer nga shteti gjerman me pasurinë e llojit automjet të blerë prej tij; (ii) evidentohen mospërputhje në deklaratimet e bëra mbi destinacionin e vlerave monetare të deklaruara si të marra hua në vitin 2009; (iii) deklarohet ndryshimi i destinacionit të huave, pra nga hua të marra për shpenzime mjekësore në hua të marra për blerje automjeti në vlerë të konsiderueshme; (iv) evidentohen vonesa në shlyerjen e këtyre huave – Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën reale të këtyre marrëdhënieve të huamarrjes.

65.1 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të shpjegojë dhe argumentojë në mënyrë shteruese, si dhe të depozitojë dokumentacion të mundshëm shtesë në lidhje me këto marrëdhënie huaje dhe deklaratimet e bëra mbi to.

66. Gjithsesi, në kushtet kur rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi subjekti ka referuar këto dy vlera monetare të marra hua nga shtetasi Gj.M dhe A.S , në përputhje me pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ata kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive e, në këtë rast, burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të deklaruara si të dhëna hua në favor subjektit të rivlerësimit.

67. Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti mbi të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, Komisioni konstaton se në lidhje me shtetasin Gj.M , gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar dokumentacion bankar në dukje mbi kreditimin e 12 pagave në llogaritë e tij bankare (OTP dhe BKT) për periudhën tetor 2008 – dhjetor 2008, në total shuma 621,252 lekë.

²⁵ Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale (për përmbushje të detyrimit kontraktor) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2015.

²⁶ Kontratë huaje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 1.4.2009, redaktuar nga noteri publik, z. P.Z.

²⁷ Referojuni dokumentit “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit deklarues te interesave private”, datë 29.6.2021, përcjellë në Komision me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 5.2.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.2.2024).

67.1 Ndërsa, sa i përket shtetasit A.N.S , subjekti ka depozituar disa dokumente, të cilat duket se tregojnë se ky shtetas ka ushtruar aktivitet tregtar në qytetin e Lezhës, kryesisht në fushën e shitjes së hidrokarbureve, prej vitit 1994 e në vijim. Por, rezulton se nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga ky shtetas prej ushtrimit të këtij aktiviteti tregtar.

68. Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e përfituara prej personave të tjerë të lidhur – të pretenduara dhe deklaruara si burim i shumave të marra hua, si dhe për pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.

69. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen deri në datën 4.4.2009 të pagesës për blerjen, si dhe për zhdoganimin e automjetit tip “****”, nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të zhdoganimit të saj. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 2.16 milionë lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

70. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – duke parashtruar sa më poshtë vijon:

70.1 Së pari, Komisioni vëren se subjekti i është përmbajtur deklaratimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, për shkakun fillestar të marrjes së shumave hua nga shtetasit Gj.M dhe A.S , si dhe për ndryshimin e destinacionit të huas.

70.2 Në vijim, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se shtetasit A.S i ka marrë *cash* dhe me kërkesë të tij huan, e po në këtë mënyrë ia ka shlyer, duke sqaruar se një pjesë të shumës e ka tërhequr nga llogaria e tij bankare (llogaria e pagës), një pjesë nga llogaria bankare që kishte bashkëshortja po në Tirana Bank, si dhe pjesën tjetër nga të ardhurat e realizuara prej shitjes së sherebelës. Ndërsa referon se shumën e marrë hua shtetasit Gj.M ia ka kthyer në mënyrën që ai ia ka kërkuar, nëpërmjet bankës, ku nga llogaria e tij bankare (në Tirana Bank) ka kaluar në numrin e llogarisë që ky shtetas i ka dhënë shumat që i detyrohej. Për arsyet e rrethanat e mësipërme, subjekti argumenton se huaja ka qenë e vërtetë e jo fiktive.

70.3 Na lidhje me vonesat për shlyerjen e huave, sqaron se shtetasit A.S ia ka shlyer huan vetëm pak muaj me vonesë, ndërsa me shtetasin Gj.M ka gjetur mirëkuptim për vonesën, për arsyet që ka përmendur edhe më parë (për shkak të problemeve shëndetësore të nënës).

70.4 Sa i përket burimit të të ardhurave të huadhënësve, për shtetasin A.S referon se ai e kishte siguruar shumën ndër vite nga të ardhurat e tij jashtë biznesit dhe e mbante për nevojat e tij personale, duke depozituar si provë të re deklaratën noteriale të bërë nga ky shtetas në datën 16.8.2024²⁸.

²⁸ Deklaratë noteriale nr. **** rep., nr. *** kol., datë 16.8.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. M.M.

70.5 Ndërsa për shtetasin Gj.M sqaron se shumë që i ka dhënë hua vetë ai e ka marrë hua tek i vëllai, i ndjeri G.M. Për këtë të fundit, referon se kishte mjete të mjaftueshme financiare, pasi vetëm pak ditë pasi shtetasi Gj.M i ka dhënë hua shumë, vëllai i tij, shtetasi G.M, ka kaluar nga llogaria e tij bankare në llogarinë e huadhënësit të tij (Gj. M) shumë prej 400,000 euro, për të cilat në dijeninë e tij janë krijuar nga aktiviteti në fushën e ndërtimit. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasit Gj.M , të datës 15.8.2024²⁹.

70.6 Gjithashtu, subjekti referon se në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie nuk janë marrë parasysh të ardhurat e trashëguara, të evidentuara sipas ekspertit kontabël, që janë në shumë 840,704 lekë.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

71. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton sa më poshtë vijon:

71.1 Sa i përket deklarimeve kontradiktore lidhur me qëllimin e marrjes së huave/ndryshimin e destinacionit të shumave të marra hua, të vlerësuara në raport me rrethanat e konstatuara dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni si përfundim çmon se ato janë, të tilla që, cenojnë figurën e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë. Kështu, për sa kohë automjeti është blerë në mars të vitit 2009, ndërsa deklarimi i ndryshimit të interesave privatë të vitit 2009 është bërë nga subjekti në ILDKPKI në mars të vitit 2010, në kushtet kur subjekti pretendon se këto vlera janë përdorur për blerjen e automjetit e do duhej që kjo rrethanë të pasqyrohej në DIPP-në e vitit 2010, pra të referohej si burim krijimi i pasurisë, rezulton se këto shuma janë referuar se janë marrë hua për shpenzime mjekësore dhe familjare. Për më tepër, ky deklarim vijon edhe në deklaratat pasardhëse të interesave privatë.

71.2 Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti dështoi të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, huadhënësve A.S dhe Gj.M , për dhënien hua të shumave të deklaruara, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

71.3 Edhe sa i përket pretendimit të subjektit për mbartjen e të ardhurave në formë kursimesh ndër vite, Komisioni sjell në vëmendje se në përputhje me shkronjën “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunëse publikë”, i ndryshuar, subjektet deklaruese kanë pasur detyrimin të deklarojnë në deklaratat e interesave privatë vlerën e likuiditeteve gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Në kushtet kur rezulton se në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë subjekti dhe/apo personat e lidhur nuk kanë deklaruar shtesa/gjendje likuiditetesh *cash*, ky pretendim i subjektit gjendet i pabazuar.

72. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur

²⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.8.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. M.M.

për kryerjen deri në datën 4.4.2009 të pagesës për blerjen, si dhe për zhdoganimin e automjetit tip “***”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2009 – 4.4.2009	Vlerat në lek
A) Pasuri	2,196,998
Automjeti tip “***”	2,188,365
Ndryshim likuiditeti	8,633
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	2,196,998
D) Të ardhura	272,978
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	272,978
E) Shpenzime	234,033
Shpenzime minimale jetike	177,793
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	56,240
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 2,158,053

73. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi dhe pagesën e detyrimeve doganore në lidhje me të, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

74. Pasuria e llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 6,300 m², ndodhur në fshatin D, Njësia Administrative Sh, Bashkia Malësi e Madhe, fituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.1.2011, pasi ka qenë zyrtarisht banor i këtij fshati. Referon se është pasuri e fituar gjatë martesës dhe zotëron 50% pjesë takuese të saj.

74.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*

75. Pasuria e llojit tokë truall me sipërfaqe 300 m², ndodhur në fshatin D, Njësia Administrative Sh, Bashkia Malësi e Madhe, fituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.1.2011, pasi ka qenë zyrtarisht banor i këtij fshati. Referon se është pasuri e fituar gjatë martesës dhe zotëron 50% pjesë takuese të saj.

75.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*

76. Pasuria e llojit shtëpi banimi njëkatëshe me sipërfaqe 90 m², ndodhur në fshatin D, Komuna Sh, Malësi e Madhe, ndërtuar në vitin 1977 nga xhaxhai i tij, i ndjeri V. Gj. S. Subjekti ka deklaruar se ka qenë i falur te xhaxhai i tij sipas zakonit (ka jetuar me të që kur ka qenë në moshën 6 muajshe), por pa ndryshuar atësi e amësi. Referon se është pasuri e fituar gjatë martesës dhe zotëron 50% pjesë takuese të saj.

76.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Dokumentacion jo i plotë ligjor lidhur me përfitimin e banesës me 1 kat me sipërfaqe rreth 90 m², në fshatin D, Malësi e Madhe, nga xhaxhai.*

77. Deklarimi i këtyre pasurive në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2010 subjekti e ka deklaruar pasurinë e llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 6,300 m² dhe tokë truall me sipërfaqe 300 m², të ndodhura në fshatin D, Malësi e Madhe. Gjithashtu, rezulton se ka deklaruar shtëpinë e banimit të ndodhur në fshatin D, Malësi e Madhe, me të dhënat përkatëse dhe rrethanat e përfitimit të saj, duke referuar se është në procedura regjistrimi – përfshirë edhe çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këto pasuri

78. Komisioni vëren se, për të provuar deklaramet e tij mbi mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive – bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) – subjekti ka depozituar dokumentet, si vijon:

78.1 Vërtetim nr. * prot., datë 17.3.2011,** i Komunës Sh dhe vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, i Njësisë Administrative Sh (Bashkia Malësi e Madhe), në referim të të cilëve vërtetohet se subjekti i rivlerësimit, ish-banor i fshatit D të Njësisë Administrative Sh, ka jetuar që nga lindja e tij me xhaxhain, V.S, i cili nuk ka pasur fëmijë. Gjithashtu, referohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë i falur të xhaxhai i tij. Po sipas këtyre vërtetimeve, bëhet me dije se xhaxhai i Toninit trashëgonte një shtëpi banimi, e cila ndodhet në fshatin D të Njësisë Administrative Sh. Banesa është e tipit njëkatëshe (me dy dhoma e korridor, një verandë dhe një banjo) dhe është ndërtuar në vitin 1977. Sipërfaqja e kësaj banese është rreth 90 m². Ndërtesa i përket pronësisë mbi tokën bujqësore – duke referuar AMTP-në përkatëse që i bashkëngjitet vërtetimit.

78.2 Akti i marrjes së tokës në pronësi me nr. regjistri *, datë 7.1.2011,** në referim të të cilit në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, familjes së subjektit të rivlerësimit i jepet në pronësi gjithsej 6,600 m² tokë, nga të cilat: (i) me vendndodhje ngastre në “***”, 5,000 m²; (ii) me vendndodhje ngastre në “****”, 1,000 m²; (iii) me vendndodhje ngastre në “kopshti te shtëpia”, 600 m², ku 300 m² referohen se janë truall.

79. Nga shqyrtimi i të gjithë deklarametve të bëra nga subjekti mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, duket se ai referon të drejtën zakonore, duke pretenduar se kjo pasuri ka qenë e xhaxhait të tij, të cilën e ai e ka trashëguar si fëmijë i falur dhe që ka jetuar me të. Nga ana tjetër, subjekti konfirmon se edhe familja e tij biologjike ka përfituar tokë bujqësore me AMTP, por se ai nuk ka pranuar të marrë pjesë nga kjo tokë.

80. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie³⁰, subjekti ka deklaruar se e ka përfituar me AMTP dhe se ka qenë banor i fshatit D. Por, gjithashtu ka konfirmuar se në datën 1.8.1991 ai ka qenë në përbërje familjare me prindërit e tij biologjikë. Në mbështetje të deklarametve të tij, ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 22.5.2024, të Njësisë Administrative Sh (Bashkia Malësi e Madhe), në referim të të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, me sipërfaqe 6,600 m², nga të cilat 300 m² janë truall dhe pjesa tjetër tokë e llojit arë.

81. Bazuar në ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën”, përfitonin tokë familjet bujqësore, ku secili anëtar i saj, pjesë e certifikatës familjare datë 1.8.1991, zotëronte të drejta reale/pjesë takuese si bashkëpronar mbi këtë pasuri, pavarësisht moshës së tij. Referuar akteve të administruara në dosjen e hetimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 1.8.1991 ka qenë

³⁰ Referojuni pyetësorit nr. ***.

pjesë në certifikatë familjare së bashku me familjen biologjike të tij (ku si kryetar i familjes bujqësore shfaqet babai i tij), si banues në fshatin D, Malësi e Madhe.

82. Sa më sipër, ngrihen dyshime lidhur me përfitimin e pasurive objekt vlerësimi me AMTP-në nr. ***, datë 7.1.2011, sipas ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën”. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të japë argumentet/shpjegimet e tij në lidhje me këtë konstatim.

83. Siç u evidentua edhe më sipër, gjatë hetimit administrativ subjekti ka konfirmuar se familja e tij (biologjike) ka përfitur tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën”, me kryefamiljar babain e tij, U.S (AMTP nr. ***). Por, nga ana tjetër, deklaroi se nuk ka pranuar të marrë pjesë nga kjo pasuri.

84. Në këto rrethana, në kushtet kur ai nuk ka paraqitur dokumentacion mbi heqjen dorë nga pjesa takuese mbi këtë pasuri – përfitur si pjesë e familjes bujqësore – duket se ai disponon të drejta reale mbi të, të cilat nuk janë deklaruar as në deklaratat e interesave privatë, të depozituara ndër vite në ILDKPKI, dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë konstatim.

85. Në vijim të hetimeve, pasi u pyet nga Komisioni mbi investime të mundshme të kryera mbi këto pasuri, subjekti ka deklaruar se në vitin 2023 djali i tij, K.S , dhe bashkëshortja e tij kanë investuar vlerën prej rreth 14,900 euro për rikonstruksionin e shtëpisë së banimit në fshatin D, ku përfshihen dyert, dritaret, instalimet elektrike, vendosja e çatisë së re etj.

85.1 Në mbështetje të deklarimeve të tij, ndër të tjera, subjekti ka depozituar: (i) kërkesën e personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, datë 7.6.2023, për riparimin e çatisë, pa ndryshuar formën dhe karakteristikat kryesore ekzistuese të shtëpisë në fshatin D, z. k. ***, me nr. kadastral ***, së bashku me foto të objektit; (ii) vërtetimin nr. ***, datë 7.6.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Sh , në referim të të cilit objekti shtëpi banimi me nr. kadastral ***, z. k. ***, i përket shtetases L.S ; (iii) shkresën kthim përgjigjeje të Bashkisë Malësi e Madhe (sektori i urbanistikës), me nr. *** prot., datë 7.6.2023, drejtuar shtetases L.S , në të cilën listohen punimet të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi; (iv) faturën tatimore dhe mandatpagesat bankare që lidhen me punimet dhe instalimet e kryera në këtë objekt.

86. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2023³¹ djali i subjektit ka deklaruar shpenzime të kryera, në total përgjatë vitit 2023, në shumën 14,936 euro, për rikonstruksionin e banesës në fshatin D. Referuar akteve të dosjes, duket se këto pagesa janë kryer në favor të subjekteve tregtare që kanë kryer punime dhe ofruar shërbime nëpërmjet sistemit bankar, e konkretisht nëpërmjet UniCredit Bank Itali, të urdhëruara nga djali i subjektit, K.S .

86.1 I pyetur nga Komisioni mbi burimin këtyre të ardhurave, subjekti ka deklaruar se janë të ardhura të djalit, K.S , dhe bashkëshortes së tij, shtetases italiane F.M , të siguruara nga puna në Itali.

86.2 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, K.S , dhe bashkëshortes së tij, të cilat janë deklaruar si burim për investimin e kryer në shtëpinë e ndodhur në fshatin D.

³¹ Deklaratë e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2024, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.6.2024).

87. Nga verifikimi i kryer në *Google Earth Pro*, pasi u evidentua shtëpia e banimit e ndodhur në fshatin D, duket se krahas rikonstruksionit të godinës së vjetër ka pasur një ndërtim të ri, i lidhur me truallin dhe godinën e vjetër, për të cilin subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur nuk rezultojnë të kenë bërë deklarime apo të jenë pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu, nga fotot e depozituara në lidhje me godinën kryesore duket se nga njëkatëshe ajo është shndërruar në një godinë dykatëshe, edhe në këtë rast në dukje në mungesë të lejes përkatëse të ndërtimit.

88. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur me të kanë realizuar shtesë ndërtimi dhe ndërtimin e një objekti të ri, veprime të cilat duket se bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

88.1 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi konstatimet e mësipërme, duke i kërkuar të japë detaje mbi ndërhyrjen e kryer në shtëpinë e banimit në fshatin D, si dhe mbi ngritjen e një godine të re ngjitur me të.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

89. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi gjetjet/konstatimet/kërkesat e bëra nga Komisioni në lidhje me këto pasuri – duke parashtruar sa më poshtë vijon:

89.1 *Së pari*, sqaron se sipërfaqen e tokës që i ka takuar xhaxhait të tij, V.S , e ka marrë ai, meqenëse kishte jetuar gjithmonë me të. Për këtë sipërfaqe toke është pajisur edhe me AMTP në vitin 2011. Deklaron se as xhaxhai tij, i ndjeri V.S e as bashkëshortja e tij nuk kanë përfituar tokë bujqësore nëpërmjet AMTP-së, si përfaqësues të familjes bujqësore, por vetëm kanë zotëruar sipërfaqen e tokës bujqësore sipas kufijve të vjetër. Referon se AMTP-ja për këtë sipërfaqe toke është plotësuar më vonë dhe është plotësuar në emër të tij, pasi për organet e pushtetit lokal e për të gjithë banoret e zonës së Malësisë së Madhe ishte dhe është i njohur fakti se ai ishte i falur tek xhaxhai dhe se kishte jetuar e banuar gjithmonë me të e bashkëshorten e tij (referon se ky fakt del edhe në disa dokumente zyrtare të kohës, si p.sh. në vërtetimin me nr. *** prot., lëshuar në datën 24.10.2016 nga gjimnazi “Sh.H ”, Koplík, ku ai ka kryer arsimin e mesëm). Pra, deklaron se AMTP-ja është lëshuar në emër të tij në datën 7.1.2011, vetëm për tokën bujqësore që posedon faktikisht dhe vetëm për sipërfaqen e tokës bujqësore, që i ka takuar sipas kufijve të vjetër xhaxhait të tij, V.S .

89.2 *Së dyti*, referon faktin se babai i tij biologjik, i ndjeri U.S, ka përfituar tokë bujqësore sipas AMTP-së përkatëse dhe se ky akt është plotësuar në emër të tij. Nga ana tjetër, deklaron se nuk ka marrë e nuk zotëron tokë bujqësore që zotëronte me AMTP babai biologjik, pasi ka trashëguar i vetëm gjithë pasurinë që ka lënë xhaxhai, i ndjeri V.S , me të cilin ka jetuar gjithë jetën. Thekson faktin se, megjithëse janë plotësuar AMTP-të, secili nga banorët e fshatit ka marrë tokë sipas kufijve të vjetër e jo sipas normës për frymë.

89.3 *Së treti*, deklaron se toka bujqësore e përfituar me AMTP-në e lëshuar në emër babait, U.S, zotërohet tërësisht nga vëllai tij, A (A) U.S, meqenëse vëllezërit e motrat e tjerë janë martuar e jetojnë prej vitesh jashtë shteti. Në këtë kontekst, sqaron se pavarësisht faktit se ka disponuar të drejta reale në lidhje me AMTP-në e lëshuar në emër të babait të tij biologjik, asnjëherë nuk ka marrë, zotëruar apo trashëguar asgjë nga kjo pasuri. Sipas subjekti, kjo është arsyeja e vetme që prej tij nuk janë deklaruar këto të drejta as në deklaratat e interesave privatë të depozituara

ndër vite në ILDKPKI dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Gjithashtu, sqaron se për pasuritë e prindërve të tij biologjikë nuk është çelur dëshmi trashëgimie, por se në datën 26.7.2024, para noterit, ka bërë deklaratën noteriale “Për heqjen dorë nga trashëgimia”³², me të cilën ka deklaruar se heq dorë nga të gjitha të drejtat e tij reale pasurore që trashëgon nga prindërit e tij biologjikë, U.Gj.S e T. P. S .

89.4 Si përfundim, pohon e deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë se pasurinë tokë bujqësore që zotëron e zotëron me një akt të ligjshëm, të lëshuar nga ana e organit kompetent shtetëror dhe ky akt pasqyron gjendjen reale e faktike të kësaj pasurie.

90. Në lidhje me investimin e kryer mbi banesën e ndodhur në fshat, ndër të tjera, deklaron se në vitin 2023 djali i tij, K.S , ka kërkuar që ta riparonte këtë banesë dhe se pas miratimit të dhënë ky riparim është kryer me të ardhurat që kishte siguruar nga puna në Itali, së bashku me bashkëshorten e tij, F.M, të cilët kanë riparuar e sistemuar krejtësisht çatinë e banesës, kanë ndërruar dyer e dritare, si dhe kanë riparuar rrjetin elektrik.

90.1 Sa i përket të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e këtij investimi, ka deklaruar se që nga data 15.3.2021 djali i tij, K.S , është i punësuar me kohë të plotë tek ndërmarrja “***”, në V , Verona, dhe se për vitet 2021 – 2023 ka përfituar në total të ardhura në shumën 38,496 euro. Gjithashtu, edhe për bashkëshorten e djalit, F.M , referon se ka punuar në të njëjtën ndërmarrje/shoqëri në shtetin italian dhe se për vitet 2021 – 2022 ka përfituar në total të ardhura në shumën 22,895 euro. Komisioni vëren se, në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë mbi të dhëna të punësimit në shtetin italian të djalit, K.S , dhe bashkëshortes së tij, F.M .

91. Në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni për ndërtimin e një kati shtesë, subjekti deklaron se nuk ka pasur kat shtesë, por riparim çatie, dhe se vazhdon të jetë e njëjta dhomë siç ka qenë më parë. Edhe në lidhje me dyshimet e hedhura për ngritjen e një godine të re, ngjitur me banesën, deklaron se *shumë vite më parë ngjitur me banesën ekzistuese ka qenë edhe një objekt tjetër, që është përdorur fillimisht si kasolle për bagëti, e më pas si magazinë, ku kanë ruajtur bimët medicinale që kanë mbjellë ndër vite e i kanë mbajtur derisa kanë gjetur tregun për t’i shitur, kanë ruajtur drutë, kanë ruajtur prodhimet që kanë prodhuar në tokën e tyre, si patate, qepë, hudhra, fasule etj.* Referon se ky objekt ka qenë i mbuluar me llamarinë të kuqe. Ngjitur me magazinën, para shume vitesh kanë qenë të ndërtuara edhe një banjë dhe një furrë për të pjekur bukën. Këto objekte kanë qenë të ndërtuara me mur guri e llaç e të mbuluara me tjegull vendi të përdorur. Deklaron se në gusht të vitit 2023, djali i tij, K.S , kur ka bërë riparimin e çatisë së banesës, ka riparuar dhe muret e banjës e të furrës dhe ka sistemuar të gjithë çatinë e objektit ngjitur me banesën.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

92. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasuritë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton sa më poshtë vijon:

³² Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar dokumentin “Deklaratë noteriale për heqjen dorë nga trashëgimia” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. M.N.

92.1 Sa i përket mënyrës së përfitimit të tokës bujqësore dhe banesës në fshat, Komisioni vëren se subjekti referon se i ka përfituar këto pasuri nga trashëgimia ligjore dhe sipas të drejtës zakonore – ndërkohë që në situatë faktike duket se ato janë përfituar nëpërmjet AMTP-së nr. ***, datë 7.1.2011, sipas ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën”, konfirmuar ky fakt edhe nga vetë subjekti.

92.2 Pra, nga vlerësimi në tërësi i deklarimeve të bëra, duket se në thelb subjekti referon se këto pasuri, të cilat i takojnë atij për shkak të trashëgimisë ligjore dhe të drejtës zakonore (si fëmijë i falur), organet shtetërore kanë gjetur një mënyrë për t’ia kaluar në pronësi. Ndërkohë, Komisioni vlerëson se ligjërisht subjekti nuk mund të përfitonte tokë bujqësore veçmas si kryetar i familjes bujqësore, pasi në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ai përfitonte pjesë takuese si anëtar i familjes ku bënte pjesë i regjistruar në certifikatën familjare në datën 1.8.1991. Gjithashtu, edhe në rastin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të xhaxhait të subjektit, të ndjerit V.S , subjekti ligjërisht nuk do të ishte trashëgimtar i radhës së parë dhe as i radhës së dytë, e aq më tepër të ishte trashëgimtar i vetëm. Në rast hipotetik, ai do të ishte trashëgimtar i radhës së tretë me zëvendësim, së bashku me vëllezërit dhe motrat e tij, nëse prindërit e tij do të kishin ndërruar jetë³³.

92.3 Në këtë kontekst, Komisioni argumenton se nëse fakti i mosdeklarimit të pjesës takuese mbi pronësinë e tokës bujqësore të përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën”, për të cilën është lëshuar AMTP-ja – në emër të babait të tij biologjik si kryetar i familjes bujqësore, nuk do të përbënte shkak për vlerësim negativ për efekt të këtij procesi, për shkak se kemi të bëjmë me pasuri të përfituar me ligj dhe në mungesë të dyshimeve mbi mënyrën e përfitimit të saj, por përfitimi i një toke bujqësore dhe/apo disponimi me tagra të plota i shtëpisë së banimit në rrethana të dyshimta në kundërshtim me legjislacionin mbi mënyrën e fitimit të pronësisë e vendos subjektin e rivlerësimit, i cili supozohet të jetë njohës i mirë i ligjit, në rrethana të tilla, të cilat vlerësohet se cenojnë figurën e gjyqtarit e, për rrjedhojë, cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

93. Në vijim, pasi shqyrtoi në tërësi deklarimet e bëra nga subjekti mbi investimet e kryera në shtëpinë e banimit në fshat në raport me dokumentacionin e depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, Komisioni krijoi bindjen se djali i subjektit, K.S , dhe bashkëshortja e tij, F.M , kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht investimin e kryer mbi këtë pasuri në vitin 2023.

94. Ndërsa, sa i përket dyshimeve të ngritura për ndërtimin e katit shtesë dhe të një godine të re ngjitur me godinën ekzistuese, Komisioni nuk arriti të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm mbi domosdoshmërinë e pajisjes me leje ndërtimi për punimet e kryera e, në këtë kontekst, përfundimisht nuk mund ta vlerësojë këtë rrethanë për efekt të këtij procesi.

95. Pasuria e llojit automjet tip “*”, vit prodhimi 2005, blerë në datën 11.7.2012, targuar AA ***, me vlerë 441,600 lekë.** Si burim krijimi ka deklaruar kursimet e tij nga të ardhurat e pagës si gjyqtar. Referon se së bashku me bashkëshorten zotërojnë secili 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

³³ Referojuni neneve 360 - 364 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

95.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

95.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, mënyrën e përfitimit dhe vlerën, por nuk ka referuar burimin e krijimit të saj.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këto pasuri

96. DPSHTRR-ja³⁴ informon se personi i lidhur, shtetasja L.S , ka pasur të regjistruar në emrin e saj automjetin me targë AB ***, i cili pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar rezultoi të jetë pasuria objekt vlerësimi, automjeti tip “****”.

96.1 Në vijim të verifikimit të dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja, konfirmohet se në datën 11.7.2012 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë³⁵ nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit automjet tip “****”, vit prodhimi 2005, për çmimin 441,600 lekë. Rezultoi se ky automjet ishte blerë më parë nga shoqëria shitëse në datën 4.6.2012, në shtetin italian, për shumën 2,600 euro, dhe se në datën 26.6.2012 janë kryer procedurat e zhdoganimit të tij, në dukje duke u paguar detyrimi total doganor, në shumën 99,831 lekë.

97. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen në datën 11.7.2012 të pagesës për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi (automjet tip “****”), nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie dhe/apo kryerjen e shpenzimeve të tjera për periudhën objekt analize. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 1.35 milionë lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.

98. Me anë të prapësimeve të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare në lidhje me këtë pasuri, duke kërkuar: (i) të njihen si të ardhura të ardhurat e realizuara nga shitja e sherebelës, prodhuar në tokën e tij për vitin 2012³⁶, por edhe për vitet 2013, 2014 e 2015; (ii) të zbritet vlera e përlllogaritur për shpenzimet jetike të djemve për periudhën 1.1.2012 – 30.7.2012, pasi pretendon se është ngarkuar padrejtësisht me një shumë shpenzimesh prej 893,090 lekësh për djemtë e tij për këtë periudhë, si shpenzime për ushqim e fjetje në Itali³⁷; (iii) të përfshihen në analizë të ardhurat e mbartura nga vitet paraardhëse – sipas aktit të ekspertimit kontabël të depozituar prej tij.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.2.2021).

³⁵ Dokumenti faturë tatimore nr. ***, datë 11.7.2012.

³⁶ Deklaron se këtë bimë e ka shitur tek subjekti “****” sh.p.k., B dhe se e provon me fletë daljen nr. ***, datë 4.7.2022 dhe me vërtetimin nr. ***, datë 14.6.2024, lëshuar po nga ky subjekt.

³⁷ Në lidhje me këtë rrethanë, parashtron se: “Nga data 4.9.2010 deri më 20.2.2015, për rrjedhojë edhe periudha kohore nga data 1.1.2012 deri më 11.7.2012, fëmijët e tij, K.S e K.S kanë jetuar e banuar në familjen e shtetasve K e V.S, në adresën: *Via “****” ***, Comune di G, Provincia di Mantova, Itali* dhe se gjatë kësaj kohe ata nuk kanë shpenzuar asgjë as për ushqim e as për fjetje, pasi këto u janë përballuar nga priti, familja S, duke deklaruar se fëmijët e tij kanë jetuar e banuar si pjesë e kësaj familjeje. Në mbështetje të deklaratimeve të tij ka depozituar dokumentacion provues lidhur me rezidencën e djemve të tij dhe deklaratë nga priti.

99. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasuritë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton si vijon:

99.1 *Së pari*, sa i përket të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga shitja e sherebelës, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e saj, jo vetëm për periudhën objekt analize, por edhe për periudhat e tjera të pretenduara. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare nuk do të reflektohen të ardhura nga ky burim.

99.2 *Së dyti*, sa i përket shpenzimeve të përlllogaritura për fëmijët e subjektit për qëndrimin në shtetin italian, në një qasje garantiste, si dhe në kushtet kur për periudhën në fjalë, por edhe periudhat pasardhëse dhe pasardhëse³⁸ të qëndrimit të tyre në këtë shtet, provohet rezidenca e palës pritëse dhe pranohet prej tyre mbulimi i shpenzimeve, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit³⁹, trupi gjykues vendosi që atyre t'u llogaritet si shpenzim ditor vetëm vlera prej 5 euro në ditë për person.

99.3 *Së fundmi*, sa i përket kërkesës së përsëritur për mbartjen e të ardhurave në formë kursimesh *cash*, në mungesë të deklarimeve të bëra mbi shtesa/gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë para vitit 2012, Komisioni e gjen të pabazuar në ligj e në prova këtë pretendim.

100. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen deri në datën 11.7.2012 të pagesës për blerjen e automjetit tip “****”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2012 – 11.7.2012	Vlerat në lek
A) Pasuri	692,920
Automjeti tip “****”	441,600
Ndryshim likuiditeti	251,320
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	692,920
D) Të ardhura	598,574
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	598,574
E) Shpenzime	629,371
Shpenzime minimale jetike	221,388
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	141,117
Shpenzime qëndrimi/fjetjeje/ushqimi në Itali, K.S	133,433
Shpenzime qëndrimi/fjetjeje/ushqimi në Itali, K.S	133,433
Balanca e fondeve (D-C-E)	-723,717

³⁸ Me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi rezidencën e fëmijëve të tij dhe deklarata të palëve pritëse për mbulimin e shpenzimeve të tyre.

³⁹ Referojuni vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 11/2019 (JR).

101. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi dhe pagesën e detyrimeve doganore në lidhje me të, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare për periudhën 1993 – 31.12.2003 dhe vitet 2004 – 2016

102. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe pasi u vlerësuan me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën 1.8.1995 – 31.12.2003 dhe vitet 2004 – 2016, nga ku duket se periudha 1993 – 31.12.2003, si dhe vitet 2004, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, paraqiten me balancë negative fondesh, konkretisht: (i) për periudhën 1993 – 31.12.2003, balanca negative e fondeve (-5,864,049 lekë); (ii) për vitin 2004, balanca negative e fondeve (-947,833 lekë); (iii) për vitin 2007, balanca negative e fondeve (-95,419 lekë); (iv) për vitin 2008, balanca negative e fondeve (-194,769 lekë); (v) për vitin 2009, balanca negative e fondeve (-2,383,261 lekë); (vi) për vitin 2010, balanca negative e fondeve (-605,437 lekë); (vii) për vitin 2011, balanca negative e fondeve (-433,866 lekë); (viii) për vitin 2012, balanca negative e fondeve (-827,449 lekë); (ix) për vitin 2013, balanca negative e fondeve (-810,369 lekë); (x) për vitin 2014, balanca negative e fondeve (-520,322 lekë); (xi) për vitin 2015, balanca negative e fondeve (-1,199,778 lekë); (xii) për vitin 2016, balanca negative e fondeve (-652,221 lekë)⁴⁰.

103. Si konkluzion, referuar kësaj analize, rezulton një balancë negative fondesh, në total në vlerën prej rreth 14.5 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1993 – 31.12.2003, si dhe vitet 2004, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

104. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁰ Referojuni tabelës së analizës përmbljedhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

B. KONTROLLI I FIGURËS

105. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës⁴¹.

106. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

107. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁴² mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

108. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj.

109. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁴³ për përditësimin e raportit për vlerësimin e figurës me informacione shtesë të mundshme, duket se në mungesë të të dhënave të reja, mbi bazën e të cilave mund të përditësohej ky raport, AKSIK (ish-DSIK) me vendimin e KDZH-së nr. *** prot., datë 16.6.2023, ka deklasifikuar plotësisht raportin e dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj⁴⁴.

110. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga organet e verifikimit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese.

110.1 Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni, ndër të tjera, administroi dosjet/fashikujt e plotë të disa çështjeve gjyqësore penale⁴⁵, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

111. Për rrjedhojë, Komisioni bën me dije se konkluzionet e raportit të kontrollit të figurës – pasqyruar si më sipër – do të vlerësohen edhe në raport me shqyrtimin e këtyre çështjeve

⁴¹ Referuar nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

⁴² Raporti i AKSIK-së (ish-DSIK) me nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁴³ Shkresë nr. **** prot., datë 10.2.2023, e Komisionit.

⁴⁴ Raporti i deklasifikuar i përcjellë me shkresën e AKSIK-së nr. *** prot., datë 22.6.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023).

⁴⁵ Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 22.5.2024 dhe shkresë kthim përgjigjeje e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. *** prot., datë 5.6.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.6.2024).

gjqësore penale të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruara në këtë vendim në rubrikën “Çështje të tjera”, në kriterin e vlerësimit profesional.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁴⁶

112. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

113. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

114. Në vijim, në këtë raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 dokumentet gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I, në raportin e plotë të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa, 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

115. Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit, zbatimit të ligjit, si dhe në arsyetimin ligjor. Në lidhje me aftësitë organizative, është konstatuar se subjekti në përgjithësi ka aftësi të mira për të përballuar ngarkesën në punë. Gjithashtu, referohet se subjekti ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga të dhënat e deklaruara dhe 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

116. Gjithsesi, nga analizimi i 3 dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, në raport janë listuar disa gjetje që lidhen me: (i) tejkalimin e afatit standard të gjykimit në disa dosje; (ii) mosrespektimin e standardit të transparencës dhe solemnitetit në gjykim, në zhvillimin e seancave pa regjistrim audio; (iii) vonesën në zhvillimin e seancave gjyqësore pa dokumentuar shkakun e vonesës.

117. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, nga ku rezultoi se nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me kriterin e vlerësimit profesional. Por, nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se qëndrojnë gjetjet e evidentuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më sipër.

⁴⁶ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 3.1.2022.

118. Në vlerësimin e gjyqtarit Tonin Sterkaj u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 12 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me disa gjetje të evidentuara gjatë shqyrtimit të dosjeve gjyqësore, që lidhen me pesë denoncime, konkretisht në lidhje me: (i) vonesa në arsyetimin e vendimeve përtej afatit ligjor; (ii) zvarritje të procesit gjyqësor përtej afateve standarde të kohëzgjatjes së gjykimeve; (iii) shtyrje të seancave gjyqësore pa dokumentacion provues mbi shkaqet e shtyrjeve; (iv) vendimmarrje përtej tagrave ligjorë; (v) konstatime në lidhje me cenimin e cilësisë së vendimeve, të pasqyruara në mënyrë të detajuar si në vijim.

DENONCIME

Denoncim i shtetases A.A⁴⁷

119. Nëpërmjet kësaj ankese, denoncuesja ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, është me vonesë në arsyetimin e vendimit, duke tejkalluar afatet ligjore.

119.1 Mbi bazën e këtyre fakteve dhe të dhënave të çështjes, Komisioni kërkoi informacion⁴⁸ Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila informoi⁴⁹ se gjykimi i kësaj çështjeje ka përfunduar pranë kësaj gjykate që në datën 19.12.2022 dhe se dosja ndodhet pranë gjyqtarit relator, z. Tonin Sterkaj, për arsyetimin e vendimit.

119.2 Pas informacionit të dërguar nga gjykata, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa u konstatua se ka kaluar 1 vit e gjysmë pa arsyetuar që nga data e shpalljes së vendimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 382/2 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe duke sjellë për rrjedhojë mohim të së drejtës ligjore të ankimimit nga ana e denoncueses.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

120. Komisioni vëren se në shpjegimet e paraqitura subjekti i rivlerësimit e ka pranuar vonesën në arsyetimin e vendimit, duke cituar se ka pasur shkaqe objektive që e kanë çuar në vonesë, si: ngarkesa në punë dhe tejzgjatja e gjykimeve përtej orarit zyrtar.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

121. Trupi gjykues, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në raport me dokumentacionin e administruar për çështjen objekt vlerësimi dhe kuadrin ligjor përkatës, vëren se:

121.1 Në nenin 382/2 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij”*. Ndërsa në pikën 4 të këtij neni parashikohet shtyrja e afatit, si vijon: *“Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës”*.

121.2 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se ka pasur shkaqe ligjore të cilat e kanë çuar atë në vonesë në arsyetimin e vendimit. Ngarkesa në punë, referuar nga subjekti, përfaqëson

⁴⁷ Ankesë nr. *** prot., datë 6.9.2022.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.5.2024, dërguar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

një indikator sasior, e cila mat dhe vlerëson subjektin e rivlerësimit në kuptim të kriterit të aftësive organizative, por kurrësi nuk mund të përbëjë shkak që të justifikojë vonesën ekstreme në arsyetimin e vendimit në një kohë prej 1 viti e gjysmë.

121.3 Trupi gjykues çmon se ky qëndrim pasiv i subjektit, përkundrajt arsyetimit të vendimit në një kohë kaq të gjatë, përbën një të metë, e cila duhet vlerësuar në kuptim të kriterit profesional. Në rastin konkret, mosrespektimi i kësaj dispozite të detyrueshme ligjore nga subjekti ka sjellë për pasojë jo vetëm cenimin e garancive ligjore të denoncueses për një proces të rregullt ligjor të kryer brenda një afati të arsyeshëm, por gjithashtu edhe të parimit të sigurisë juridike, proklamuar në Kushtetutë dhe, më së gjeri, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në drejtim të rëndësisë që ka për sa i përket çështjes së besueshmërisë së publikut tek organet e drejtësisë. Në këtë kuptim, trupi gjykues thekson se subjekti i rivlerësimit, me atributin e *garantit* të ligjit, ka pasur detyrimin që përmes funksionit të dhënies së drejtësisë në bazë dhe zbatim të ligjit të respektojë të drejtat e palëve për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. Nga mosrespektimi i dispozitave ligjore subjekti i rivlerësimit ka krijuar vonesë në realizimin e tyre, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi dhe ankimi para organeve të drejtësisë nga denoncuesja.

122. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo gjetje është e mjaftueshme për t'u përfshirë në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, pesha e së cilës do të vlerësohet në harmoni me gjetjet e tjera të rezultuara në këtë vendim.

Denoncim i shtetasve M dhe S.B⁵⁰

123. Denoncuesit, në ankesën e paraqitur në cilësinë e personave të dëmtuar, kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit shtyn seancat në mënyrë të pakuptimtë dhe në kundërshtim me ligjin, duke arritur të zvarrisë gjykimin dhe të sjellë pasoja për ta në çështjen penale në ngarkim të të pandehurve Y. R., H. R. etj., regjistruar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

124. Komisioni, mbi bazën e këtyre indicieve, kërkoi dhe administroi informacion në lidhje me çështjen, si dhe dosjen e plotë gjyqësore⁵¹ që lidhet me çështjen penale, të regjistruar me nr. *** regj., procedim penal nr. ***/***, në ngarkim të shtetasve Y. R., H. R. etj.

124.1 Nga administrimi i dosjes gjyqësore vërehet se çështja penale “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***/*** të Prokurorisë së Rrethit Shkodër” është regjistruar me nr. *** regjistri në datën 18.1.2019 dhe ka përfunduar me vendimin datë 23.12.2019, ku është vendosur “Deklarimi fajtor i të pandehurve H. R., A. R., B. R. dhe A. R., për kryerjen e veprës penale “Plagosja e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 3 muaj burgim”. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke i vënë të pandehurit në provë, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejnë veprë tjetër penale.

124.2 Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, vërehet se nga seanca e parë e datës 18.2.2019 e deri në seancën e datës 17.9.2019 janë shtyrë 16 seanca gjyqësore (pra procesi është shtyrë 7 muaj, pa përfshirë këtu muajin gusht, për shkak të lejes së zakonshme). Vërehet se

⁵⁰ Ankesë nr. *** prot., datë 7.11.2019.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.5.2024 dhe kthim përgjigjeje me shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2024, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.5.2024, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2024, nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

shtyrja e seancave është kryer kryesisht për mungesë të të pandehurve, megjithëse duket se çështja nuk ka qenë komplekse, pasi vepra penale për të cilën të pandehurit po gjykoheshin ka qenë kundërvajtja penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

125. Për sa më lart, Komisioni konstatoi zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe tejkallim të afateve të përcaktuara për gjykimet e kundërvajtjeve penale sipas nenit 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të rregullores “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, duke i kaluar subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime/argumente, si dhe të paraqesë prova të mundshme shtesë në lidhje me këtë gjetje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

126. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se çështja ka qenë dinamike dhe se në shtyrjen e gjykimeve kanë ndikuar ndërrimi i prokurorëve të çështjes, duke referuar se janë ndërruar 3 prokurorë. Më tej, ka shpjeguar se në total janë zhvilluar 31 seanca gjyqësore, 11 prej të cilave nuk janë zhvilluar, për shkak se nuk është paraqitur prokurori, ndërsa 12 seanca të tjera janë shtyrë për mosparaqitje të të pandehurve në gjykim, për të cilat është vendosur të bëhet shoqërimi i detyrueshëm i tyre. Gjithashtu, sipas subjektit, në shtyrjen e procesit ka ndikuar edhe ndarja e çështjes, ku është proceduar me ndarjen e saj në ngarkim të të pandehurve H. R., A. R., B. R. dhe A. R., nga çështja penale në ngarkim të të pandehurit Y. R., për shkak se ky i fundit ishte larguar jashtë shteti për arsye familjare. Në këto rrethana, subjekti ka pretenduar se shtyrja e seancave është kryer për shkaqe objektive.

127. Në lidhje me tejkallimin e afateve të përcaktuara për gjykimet e kundërvajtjeve penale, subjekti ka shpjeguar se shtyrjet e seancave kanë sjellë për pasojë vonesa në gjykim, duke u përpjekur të arsyetojë në mënyrë të detajuar shkaqet e shtyrjes.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

128. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit me shkrim dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, vëren se në çështjen objekt shqyrtimi janë zhvilluar disa seanca gjyqësore, të cilat nuk kanë qenë efektive për mungesë të palëve apo prokurorit të çështjes. Kështu, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, si përgjegjës për drejtimin e seancës, bazuar në nenin 341/1 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të merrte masa që kërkesat për shtyrje, pavarësisht objektivitetit të tyre, t’i administronte brenda një afati të arsyeshëm.

128.1 Referuar nenit 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve⁵², gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë *nuk duhet të zgjasin më tepër se 4 muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale.*

128.2 Pra, konstatohet se ky afat, në rastin konkret, nuk është respektuar nga subjekti i rivlerësimit, duke çuar në një vonesë për rreth 1 vit.

129. Për sa më sipër, si dhe bazuar në: (i) afatet ligjore prekluzive për përfundimin e gjykimeve penale; (ii) mosmarrjen e masave nga subjekti i rivlerësimit si drejtues seance për administrimin e shtyrjeve të tyre brenda një afati të arsyeshëm – trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka zvarritur procesin gjyqësor. Si përfundim, trupi gjykues çmon se kjo gjetje qëndron dhe do të përfshihet në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

⁵² Miratuar me vendimin e KLD-së nr. ***, datë 14.4.2010.

Denoncim i shtetases E.S⁵³

130. Nga verifikimi i kësaj ankese vërehet se denoncuesja ankohet si palë e dëmtuar në procesin penal lidhur me procedimin penal të regjistruar me nr. ***/**, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, ndaj disa punonjësve shtetërorë. Denoncuesja, konkretisht, referon se në lidhje me këtë procedim penal është paraqitur kërkesa për pushim të hetimeve, e cila është shqyrtuar nga gjyqtari Tonin Sterkaj. Sipas denoncueses, subjekti i rivlerësimit ka paragjykuar çështjen, pasi nuk i është përgjigjur kërkesave të ngritura në proces, por, sikurse lexohet edhe nga vendimi, ka vendosur sipas kërkesës së prokurorit, pa pasur një arsyetim si gjyqtar çështjeje. Në vijim, denoncuesja pretendon se gjyqtari është i korruptuar, si dhe ka shkelur etikën profesionale⁵⁴.

131. Komisioni kërkoi⁵⁵ informacion pranë gjykatave kompetente, si dhe administroi vendimet gjyqësore⁵⁶ në lidhje me këtë çështje, pasi referohet se dosja gjyqësore është dërguar në Gjykatën e Lartë.

132. Nga administrimi i vendimeve të gjykatave kompetente ka rezultuar si vijon:

132.1 Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal me nr. ***, datë 4.10.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”, është regjistruar çështja penale me datë 25.2.2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

132.2 Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. *** (***), datë 8.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës së Prokurorit; 2. Pushimin e procedimit penal nr. ***/**, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”, duke arsyetuar se fakti për të cilin është regjistruar ky procedim nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se të kallëzuarit nuk kanë kryer veprën penale për të cilën janë dyshuar.

132.3 Në vijim, Gjykata e Apelit Shkodër⁵⁷ me vendimin nr. ***, datë 22.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** (***), datë 8.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak se denoncuesja nuk legjitimohet të paraqesë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***/**. Ndaj këtij vendimi rezulton se është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

⁵³ Ankesë nr. *** prot., datë 29.7.2019.

⁵⁴ Në mbështetje të denoncimit, denoncuesja ka bashkëlidhur dokumentacion provues; kopje të aktit kërkesë për pushimin e çështjes penale si dhe aktin e ekspertimit grafik të nënshkrimeve datë 24.1.2019.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.5.2024, dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2024, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.5.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka dërguar kopje të njëzuar të këtij vendimi të dhënë nga gjyqtari Tonin Sterkaj. Gjithashtu, ka informuar se dosja gjyqësore në lidhje me këtë çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke i adresuar kësaj gjykate kërkesën e Komisionit; shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.6.2024, e cila ka dërguar kopje të vendimit dhe ka informuar se dosja është dërguar në Gjykatën e Lartë në datën 18.9.2019.

⁵⁷ Investuar me ankimin e shtetases E. S.

133. Komisioni analizoi vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nga ku kanë rezultuar këto fakte të përgjithshme të çështjes: Nëpërmjet një shkresë të datës 13.9.2017, përcjellë për trajtim nga Kryeministria në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shtetasja E. S. ka deklaruar se është pronare e një pasurie të paluajtshme (truall dhe banesë), të përfituar me trashëgimi bashkë me të afërmit e saj, mbi të cilën është ndërtuar një kompleks banimi dhe shërbimi 8-katësh, si dhe ka kallëzuar disa fakte penale që lidhen me disponimin e kësaj pasurie. Ndër të tjera, ajo ka kallëzuar se leja e ndërtimit është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin, duke akuzuar për këtë disa punonjës të Bashkisë Shkodër. Gjithashtu, ka kallëzuar edhe në lidhje me disa akte dhurimi të falsifikuara për këtë pasuri.

133.1 Nga analizimi i fashikullit hetimor ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka hetuar mbi faktet e kallëzuara, ka caktuar ekspertë të cilët kanë përgatitur 3 aktekspertiza grafike, në lidhje me pretendimin për falsifikimin e nënshkrimeve, dhe në përfundim prokurori i çështjes, pasi ka vlerësuar faktet, ka disponuar me vendim për pushimin e hetimeve, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 328/1, shkronjat “b” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale. Në vijim, bazuar në nenin 329/a, prokurori i ka kërkuar gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) pushimin e hetimeve. Rezulton se subjekti i rivlerësimit në përfundim të gjykimit ka disponuar me vendim pranimit të kërkesës së prokurorit, duke konfirmuar vendimin për pushimin e hetimeve.

134. Në përfundim, Komisioni pasi analizoi vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova të mundshme shtesë, për të provuar të kundërtën, për sa: (i) Vendimi nuk duket të jetë paraqitur me një strukturë të qëndrueshme të një vendimi gjyqësor, ku të përmbajë: faktet e kallëzuara, të hetuara nga Prokuroria; analizën ligjore në lidhje me çmuarjen e veprimeve hetimore të kryera/urdhëruara nga prokurori në drejtim të “zbardhjes” së fakteve të kallëzuara, analizë kjo e cila të justifikonte vendimin në lidhje me pranimin e kërkesës së pushimit të procedimit penal; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk duket të ketë disponuar në vendimin përfundimtar në lidhje me dokumentacionin origjinal të sekuestruar nga prokurori për qëllime të kryerjes së aktit të ekspertimit grafik, bazuar në nenin 190⁵⁸ të Kodit të Procedurës Penale, duke e bërë vendimin e paplotë e të pavlefshëm.

135. Më tej, vërehet se denoncuesja ka kërkuar para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër: (i) ndreqjen dhe plotësimin e vendimit penal nr. *** (***), datë 8.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me provat materiale të sekuestruara gjatë hetimit për llogari të procedimit penal; (ii) deklarimin e falsitetit të deklaratës së datës 26.10.1988, “Për heqjen dorë nga pasuria shtëpi banimi”, e shtetasve L. L. etj., të bërë para përfaqësuesit të Këshillit Popullor të lagjes dhe asgjësimin për shkak të falsifikimit të përmbajtjes dhe nënshkrimeve në këtë akt.

135.1 Rezulton se subjekti i rivlerësimit me vendimin ***, datë 27.7.2020, ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës së paraqitur; 2. Ndreqjen e disa gabimeve materiale të konstatuara në vendim; 3. Provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal, mbajtja e të cilave ndalohet me ligj, të konfiskohen, të kalojnë në favor të shtetit, ndërsa sendet e tjera t’u kthehen personave që u takojnë; 4. Bazuar në nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale, deklarimin e falsitetit vetëm për sa u përket nënshkrimeve të dokumentit deklaratë e datës 26.10.1988, “Për

⁵⁸ Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar mbi disponimin e provave materiale.

heqjen dorë nga pasuria shtëpi banimi”, e shtetasve L. L. etj., të bërë para përfaqësuesit të Këshillit Popullor të lagjes. Asgjësimin e këtij dokumenti, por duke vënë më parë në dijeni personin që e ka paraqitur këtë dokument; 5. Pjesët e tjera të këtij vendimi mbeten siç janë; 6. Ky vendim t’i bashkëngjitet vendimit të korigjuar e të plotësuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

136. Nga analizimi i vendimit plotësues u gjetën problematika ligjore, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime/argumente, si dhe të paraqesë prova të mundshme shtesë, për sa konstatuar se: (i) Vendimi plotësues është dhënë me mbi 1 vit më vonë se vendimi kryesor, në kundërshtim me nenin 385/a të Kodit të Procedurës Penale; (ii) Subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim plotësimi në lidhje me deklarimin e falsitetit të një dokumenti të hetuar më parë nga Prokuroria, duke vendosur edhe asgjësimin e tij, në kundërshtim me kufijtë e vendimmarrjes si gjyqtar i seancës paraprake, parashikuar në nenet 329/b/3 dhe 329/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

137. Nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit si fillim paraqiti në mënyrë të detajuar faktet, si dhe arsyetoi në lidhje me vendimin e marrë nga ana e tij, duke sjellë para Komisionit sërish të relatuar vendimin, për të cilin Komisioni evidentoi problematika. Në vijim, subjekti ka theksuar se ka analizuar faktet e kallëzuar, ka bërë analizë të veprimeve të prokurorit, si dhe ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, për të cilin është regjistruar procedimi penal, dhe në përfundim ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorit për pushimin e hetimeve të procedimit penal, bazuar në nenin 329/a/3 të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti për të cilin është regjistruar ky procedim penal nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Në përfundim të argumenteve të tij, për sa i përket respektimit të ligjit në vendimin e marrë, subjekti ka konkluduar se vendimi është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, çka nënkupton se vendimmarrja ka qenë e drejtë dhe e bazuar në ligj.

137.1 Më tej, në lidhje me konstatimin për mungesë disponimi nga subjekti i rivlerësimit me vendim përfundimtar, duke mos u shprehur për dokumentacionin origjinal të sekuestruar për qëllime ekspertimi, ka shpjeguar se mungesa e disponimit të gjykatës për provat materiale të sekuestruara, për llogari të procedimit, nuk e bën të pavlefshëm vendimin e Gjykatës, pasi nuk mungon dispozitivi i vendimit, që sipas subjektit ka qenë vendimmarrja në lidhje me kërkesën për pushim të hetimeve, as nënshkrimi i tij në vendim, si dhe nuk ka kontradiktë mes arsytimit dhe dispozitivit të tij. Subjekti, gjithashtu, ka arsyetuar se në rastin konkret nuk mund të dispononte mbi kthimin e sendeve, pasi provat materiale që duhej të ktheheshin ishin dokumente që u ishin sekuestruar personave fizikë e juridikë të tretë për kryerjen e aktit të ekspertimit grafik, për të cilat, bazuar në nenin 218/2 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të dëgjoheshin paraprakisht.

137.2 Në lidhje me konstatimet për sa i përket vendimit plotësues, subjekti në shpjegimet e dhëna është përpjekur të justifikojë vendimmarrjen e tij, duke e ndërlidhur me vendimin e formës së prerë të dhënë nga Gjykata e Apelit. Sipas subjektit, nuk mund të dispononte mbi provat materiale derisa vendimi të merrte formë të prerë, pasi ato mund të përdreshin nga palët në një proces tjetër, pra dokumenti i falsifikuar mund të përdorej përsëri nga palët për arsye përfitimi të padrejtë dhe do të sillte pasoja të pariparueshme. Për këto arsye, sipas subjektit, është parë e drejtë të ndërhyhet me vendim plotësimi, pasi vendimi mori formë të prerë.

Gjithashtu, subjekti ka theksuar se kërkesa për ndreqje vendimi nuk mund të refuzohet, pasi ishte e bazuar në prova dhe në vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Shkodër.

137.3 Në vijim, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij edhe në lidhje me barrën e provës së lënë mbi vendimmarrjen e tij në kundërshtim me ligjin, duke u ndalur tek fakti që si gjyqtar i çështjes ka qenë i detyruar t'i përgjigjej kërkesës së prokurorit për kthimin e dokumenteve që kanë shërbyer për hartimin e aktit të ekspertizave, por, për t'u kthyer ato, më parë duhej të deklaroheshin akte të falsifikuara e, për këtë qëllim, në vendimin për plotësimin e vendimit ka disponuar në lidhje me këto pika. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar gjithashtu se edhe prokurori ka qenë i pranishëm në seancën për plotësimin e vendimit dhe ka qenë dakord me kërkesën e paraqitur nga pala e interesuar.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

138. Trupi gjykues, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në raport me dokumentacionin e administruar për çështjen objekt vlerësimi dhe kuadrin ligjor përkatës, çmon se ai nuk arriti të provonte të kundërtën mbi konstatimet bëra, për arsyet si vijon:

138.1 Në lidhje me cilësinë e vendimit nr. *** (***), datë 8.5.2019, për pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 4.10.2017, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, subjekti nuk arriti të shpjegonte përtej vendimit të marrë se vendimi ka qenë i arsyetuar dhe i është nënshtruar një analize të hollësishme të fakteve dhe provave, që e kanë çuar prokurorin e çështjes në kërkesën për pushimin e procedimit e duke i vlerësuar ato në kuptim të elementeve që përcaktojnë përgjegjësinë penale. Mungesa e elementeve, si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, evidentuar në vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, tregojnë qartazi për mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

138.2 Në lidhje me disponimin e mëtëjshëm të subjektit me vendim plotësimi nr. ***, datë 27.7.2020, si dhe gjetjet e konstatuara nga Komisioni, subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e tyre. Nga vlerësimi i dy vendimeve të marra nga subjekti, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ishte shprehur në vendimin kryesor në lidhje me kërkesën për kthimin e akteve që kanë shërbyer për kryerjen e aktekspertizave, të metë të cilën e plotëson me vendimin plotësues. Kërkesa e paraqitur nga shtetasja E.S, në rastin konkret denoncuesja, për plotësimin e vendimit, rezultoi të ishte paraqitur jashtë afateve ligjore, përcaktuar në nenin 385/a të Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, edhe vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është marrë në kundërshtim me këtë dispozitë.

138.3 Trupi gjykues çmon se është i pabazuar pretendimi i subjektit në lidhje me mosdisponimin në vendimin kryesor për aktet e sekuestruara nga Prokuroria, deri kur vendimi të merrte formë të prerë në Apel. Ai ka përdorur këtë si arsye për të justifikuar vendimin plotësues, pasi, nëse do të ishte para këtij vlerësimi, subjekti duhej ta shprehte në vendim, meqë kishte detyrimin të justifikonte qëndrimin e tij në lidhje me kërkesën e paraqitur nga prokurori i çështjes për kthimin e akteve. Pa pasur qëllim të zëvendësojë në këtë çështje logjikën e gjyqtarit, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të dispononte në vendimin kryesor në lidhje me fatin e akteve të sekuestruara gjatë procesit të hetimit penal, me rezervën që ato të bëheshin të disponueshme pasi vendimi të marrë formë të prerë.

138.4 Mbi bazën e së njëjtës logjikë, trupi gjykues çmon se edhe deklarimi i falsitetit të aktit “Deklaratë e datës 26 tetor 1988”, nëpërmjet një procesi plotësim vendimi, dikton përpjekjet e subjektit për të justifikuar moszbatimin e detyrimit për t’u shprehur në vendimin kryesor në lidhje me falsitetin e aktit, nëse e vlerësonte si të tillë. Gjithsesi, nga analiza që i është bërë dosjes penale, konkretisht akteve të ekspertimit, nuk u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm falsiteti i këtij akti.

139. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se subjekti në këtë çështje nuk ka shfaqur cilësi të mjaftueshme në drejtim të aftësive për të interpretuar ligjin, për të arsyetuar vendimin, mangësi këto të cilat do të vlerësohen bashkë me gjetjet e tjera të evidentuara në këtë vendim.

Denoncim i shtetasës R.K⁵⁹

140. Në ankesën e bërë, denoncuesja referon, ndër të tjera, se ka pasur një proces penal të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e të pandehurës, e akuzuar për veprat penale “Fyerja” dhe “Shpifja”, ku në përfundim është shpallur e pafajshme për veprën penale “Shpifja” dhe fajtoje për veprën penale “Fyerja”. Denoncuesja ankohet në lidhje me vendimin e dhënë nga subjekti si vendim i njëanshëm, i paarsyetuar mirë, si dhe ka pretenduar se i është mohuar marrja e dokumentacionit dhe regjistrimeve audio⁶⁰.

141. Komisioni administroi⁶¹ dosjen gjyqësore që lidhet me këtë çështje, nga analizimi i së cilës kanë rezultuar këto fakte: shtetasja K. B. ka kërkuar para Gjykatës deklarimin fajtor të së kallëzuarës, shtetasës R. K., akuzuar për veprat penale “Fyerja” dhe “Shpifja” dhe dënimin e saj në shumën 50,000 lekë për secilën vepër penale. Subjekti i rivlerësimit i caktuar për këtë çështje, pasi ka përfunduar shqyrtimin, ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 27.2.2020, duke deklaruar të pafajshme shtetasen R.K. për veprën penale “Shpifja” dhe fajtoje për veprën penale “Fyerja”, parashikuar nga neni 119/2 i Kodit Penal, e duke i caktuar asaj detyrimin për pagesën e gjobës në masën prej 60,000 lekë.

142. Pas analizimit të këtij vendimi, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime/prova për sa dukej se nuk ishte marrë qëndrimi i së kallëzuarës, ku bëhet shkak për vendim të njëanshëm, si dhe për disa pretendime për mosvënien në dispozicion të kopjes së regjistrimit të seancave.

143. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, duke respektuar të drejtat e të dyja palëve në proces. Referon se e kallëzuara është mbrojtur nga një avokat, që ajo vetë kishte zgjedhur, të cilët kanë qenë të pranishëm në gjykim dhe kanë paraqitur pretendimet e tyre në çdo fazë të gjykimit, të cilat, pasi janë vlerësuar në harmoni me provat, është proceduar me vendimmarrje.

143.1 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se gjatë gjithë gjykimit nuk ka disponuar asnjëherë me vendim, që t’i refuzohet e drejta për të marrë kopje të regjistrimit, por përkundrazi, janë respektuar të drejtat e secilës palë në proces.

⁵⁹ Ankesë nr. *** prot., datë 16.6.2020.

⁶⁰ Denoncuesja ka bashkëlidhur kopje të vendimit nr. ***, datë 27.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili duket se është printuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

⁶¹ Shkresat nr. *** prot., datë 16.5.2024 dhe nr. *** prot., datë 24.5.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.5.2024); shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

144. Si përfundim, në vlerësim objektiv të prapësimeve në raport me dokumentacionin e administruar në këtë kuadër, trupi gjykues i gjen bindëse dhe të bazuara shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me çështjen objekt denoncimi.

Denoncim i shtetasit P.G⁶²

145. Në ankesën e paraqitur, denoncuesi referon se është pronar i ligjshëm i një pasurie ndërtesë dhe ka kallëzuar se disa punonjës shtetërorë kanë vepruar në mënyrë të paligjshme duke i shembur ndërtesën, pra duke e dëmtuar atë. Më tej, ai referon se këto fakte i ka kallëzuar në prokurori, ku në vijim është regjistruar çështja penale me nr. procedimi ***/**, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe se, pas kryerjes së hetimeve, prokurori i çështjes me vendimin e datës 7.7.2015 ka vendosur pushim të procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Vendimi i pushimit është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe është vendosur detyrimi i Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Organi i Prokurorisë ka vijuar hetimet dhe në përfundim ka disponuar sërish me vendim për pushim të hetimeve të procedimit penal me nr. ***/**, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

145.1 Në vijim ka rezultuar se vendimi i prokurorit është ankimuar përsëri në gjykatë, ku për këtë çështje është ngarkuar subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ka theksuar se për gjykimin e kësaj çështjeje subjekti ka zhvilluar 18 seanca e, në përfundim, me vendimin nr. **, datë 6.4.2018, ka vendosur miratimin e vendimit të pushimit të çështjes për procedimin penal me nr. ***/**. Ndër faktet e paraqitura, denoncuesi ndalet të theksojë se subjekti i rivlerësimit i ka shtyrë 8 herë seancat gjyqësore pa asnjë shkak ligjor.

145.2 Ndër pretendimet e ngritura në këtë denoncim, denoncuesi referon gjithashtu se subjekti ka kryer shkelje të ligjit procedural, pasi nuk e ka shqyrtuar çështjen me dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuara me ligjin nr. ***/**, pretendim i cili nuk u gjet i bazuar, pasi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi më vonë sesa mbyllja e hetimit nga prokurori dhe, rrjedhimisht, edhe shqyrtimi i çështjes nga subjekti është bazuar në dispozitat që kanë qenë në fuqi në kohën e vendimit për pushimin e procedimit penal nga prokurori⁶³, bazuar në nenin 524⁶⁴ të ligjit nr. ***/**.

146. Komisioni administroi⁶⁵ dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. *** (***), datë 6.4.2018, të subjektit të rivlerësimit, si dhe dy fashikuj të procedimit penal nr. ***/**. Nga administrimi i dosjes gjyqësore vërehen këto fakte:

146.1 Me vendimin e datës 27.7.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. **, datë 20.3.2015, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

146.2 Mbi bazën e ankimit të paraqitur nga denoncuesi datë 29.7.2017, është investuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku çështja është regjistruar në datën 30.9.2017. Subjekti i

⁶² Ankesë nr. *** prot., datë 11.9.2018.

⁶³ Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, bërë me ligjin nr. ***/**, kanë hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, pra më vonë se vendimi i prokurorit.

⁶⁴ Në këtë nen thuhet se: “Aktet dhe provat e marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe të përdorshme edhe në rastet kur ky ligj parashikon rregullime të ndryshme”.

⁶⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 16.5.2024 dhe nr. *** prot., datë 24.5.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.5.2024), të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

rivlerësimit ka caktuar seancën gjyqësore në datën 17.10.2017. Vërehet se për gjykimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 17 seanca, nga të cilat 12 gjyqësore dhe 5 seanca për shpallje vendimi. Nga këto seanca, vërehet se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për mungesë të palëve/prokurorit të çështjes. Në seancën e datës 19.2.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes duke u tërhequr për vendim.

146.3 Ndërkohë, në vijim ka rezultuar se për marrjen e vendimit subjekti ka zhvilluar 5 seanca, nga data 28.2.2018 deri më 6.4.2018, datë në të cilën ka shpallur vendimin.

146.4 Referuar procesverbaleve gjyqësore, vërehet se shkak për shtyrjen e seancave për vendimmarrjen kanë qenë kryesisht kompleksiteti i çështjes, arsyet shëndetësore, angazhimi në trajnime/seminare, shkaqe këto të përsëritura disa herë nga subjekti.

147. Por, nga verifikimi i dosjes gjyqësore, Komisioni konstatoi se nuk gjendet dokumentacion që të provojë shkaqet e shtyrjes së seancave për shpallje vendimi. Mbi bazën e këtij konstatimi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të provojë në lidhje me pamundësinë për të marrë vendimin menjëherë pas seancës së konkluzioneve përfundimtare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

148. Komisioni vëren se në prapësimet e paraqitura subjekti është ndalur në analizimin e vendimeve të tij për shtyrjet e seancave dhe kryesisht seancat në lidhje me shpalljen e vendimit për periudhën kohore 19.2.2018 – 6.4.2018. Kështu, subjekti ka shpjeguar se në këtë periudhë ka pasur ngarkesë të madhe pune, ka gjykuar çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe atë Kurbin, i deleguar me vendimet përkatëse të KLD-së, ka marrë pjesë në seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, ka qenë me leje për arsye familjare e shëndetësore, duke paraqitur dokumentacion provues⁶⁶ për lejen dhe se për tri ditë punë të kësaj periudhe ka qenë pushim për shkak të festave zyrtare, duke referuar datat e tyre.

148.1 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se çështja ka qenë komplekse, e ndërlikuar e voluminoze dhe për shkak të këtyre angazhimeve i është dashur kohë të rinjohet me aktet e procedimit penal.

148.2 Në përfundim, subjekti ka parashtruar se ndaj vendimit të marrë nuk është paraqitur ankim nga Prokuroria, por vetëm nga ana e ankuesit P.G, ku në përfundim të shqyrtimit gjykatat më të larta kanë lënë në fuqi vendimin e marrë, duke theksuar se vendimmarrja e tij ka qenë në përputhje të plotë me ligjin e provat.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

149. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe e dëgjoi në seancë dëgjimore, çmon se ai nuk arriti të provonte të kundërtën në lidhje me pamundësinë absolute për të shpallur vendimin, sikurse kërkohet nga ligji.

149.1 Kështu, në nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale, me titull “Menjëhershmeria e marrjes së vendimit”, përcaktohet se: (1) *Vendimi merret menjëherë pas diskutimeve përfundimtare të palëve;* (2) *Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet, përveçse në rast pamundësie absolute. Shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar.*

⁶⁶ Kërkesë dhe vendim datë 7.3.2018 për miratim dhënie leje nga kryetari i Gjykatës, për datat 9, 12 e 13 mars 2018.

149.2 Referuar kësaj dispozite, normohet rëndësia e fazës së shpalljes së vendimit, duke e lidhur me detyrimin për ta shpallur menjëherë pas diskutimeve përfundimtare. Nga ana tjetër, për shkaqe të pamundësisë absolute, parashikohet shtyrja e seancës kundrejt një procedure, e cila detyrimisht kërkohet të miratohet nga kryetari.

149.3 Në rastin konkret, nga analizimi i dosjes, si dhe më tej, nga vlerësimi i shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në vijim të barrës së provës, çmohet se ai nuk arriti të provonte se ka qenë në këto rrethana. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit, se ka pasur shkaqe të arsyeshme për shtyrje, nuk mbështeten në dokumentacion provues. Në dosjen gjyqësore nuk u gjend asnjë dokument/akt që të provonte shkaqet e cituara në procesverbalet gjyqësore për shtyrjet e seancave, si: angazhimin e tij në disa gjykata të rretheve si gjyqtar i deleguar, pjesëmarrjen në seminare trajnuese apo shkaqe shëndetësore. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në lidhje me disponimin e një lejeje nga kryetari i Gjykatës për tri ditë, në datat 9, 12 e 13 mars, nuk lidhet dhe nuk është bërë shkak shtyrjeje për këtë çështje. Për më tepër, referuar vendimit të miratimit të lejes, datë 7.3.2018, lëshuar nga kryetari i Gjykatës, është cituar si arsye miratimi që në këto data subjekti nuk ka planifikuar gjykime dhe, për pasojë, nuk bëhet pengesë për mbarëvajtjen e proceseve.

150. Pasi analizoi rrethanat e faktit, si dhe shpjegimet e provat e paraqitura, trupi gjykues vlerëson përfundimisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me shpalljen e vendimit, duke i shtyrë seancat pa shkaqe të arsyeshme dhe se, nga mosshpallja e vendimit për një afat relativisht të gjatë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt ligjor, duke vështirësuar realizimin e të drejtave të tyre brenda afateve ligjore, çka çmohet se përbën shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Konkluzione përmbledhëse në lidhje me shqyrtimin e denoncimeve

151. Për sa më sipër, trupi gjykues, pasi shqyrtoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, çmon se subjekti me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut. Pas analizimit dhe vlerësimit në tërësi të denoncimeve të depozituara nga publiku dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni konstatoi shkelje të përsëritura të afateve për përfundimin e gjykimit, për arsyetimin e vendimeve, gjetje të kriterit të aftësive profesionale, për të cilat subjekti nuk arriti të shpjegojë/të provojë të kundërtën.

152. Trupi gjykues çmon se gjetjet e konstatuara nuk duhen parë ngushtësisht vetëm si mangësi profesionale të subjektit, në kuptim të kriterit të aftësive profesionale, por më gjerë, nisur nga pasojat që kanë sjellë tek publiku në drejtim të cenimit të garancive për një proces të rregullt ligjor.

Çështje të tjera

153. Siç u referua edhe më sipër, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfutuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni administroi informacion dhe dokumentacion për disa çështje gjyqësore penale, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

154. Pas verifikimit dhe analizimit të këtyre gjashtë dosjeve gjyqësore penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke i kërkuar sa vijon:

154.1 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasit A. L. dhe D. P., akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal: (a) të japë shpjegimet/sqarimet e tij për rrethanat e relatuar në analizimin e kësaj dosjeje, në referim të të cilave rezulton se Gjykata e Apelit ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në analizë të gabuar të provave të administruara në gjykim, lidhur me deklarin e pafajshëm të të pandehurit A. L.; (b) të paraqesë në mënyrë të përmbledhur dhe shteruese shpjegimet/argumentet e tij mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat çuan trupin gjykues në caktimin e masës së dënimit më të ulët nga sa kishte kërkuar Prokuroria – për të pandehurin tjetër, shtetasin D. P.

154.2 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasit P. S., E. M. dhe S. U., akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal: (a) të paraqesë në mënyrë të përmbledhur dhe shteruese shpjegimet/argumentet e tij mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat çuan trupin gjykues në caktimin e masave më të ulëta të dënimit nga sa kishte kërkuar Prokuroria – për të pandehurit e kësaj çështjeje; (b) të japë shpjegime shteruese dhe të argumentojë mbi përmbushjen/plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe, si rrjedhojë, disponimin me vendim për pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me burgim për të pandehurin E. M.

154.3 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin M. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, iu kërkuar të japë shpjegime shteruese dhe të argumentojë mbi përmbushjen/plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe, si rrjedhojë, disponimin me vendim për pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me burgim.

154.4 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin S. D., akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, subjektit iu kërkuar të paraqesë në mënyrë të përmbledhur dhe shteruese shpjegimet/argumentet e tij mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat çuan trupin gjykues (ku ai ishte në cilësinë e kryesuesit) në caktimin e një mase më të ulët dënimi nga sa kishte kërkuar Prokuroria – për të pandehurin e kësaj çështjeje, kjo në vlerësim edhe të rrethanave të ngjarjes dhe rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin veprat penale.

155. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e referuara/e depozituara, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet, problematikat e ngritura dhe/apo kërkesat e bëra nga Komisioni, pas shqyrtimit të katër çështjeve gjyqësore penale të referuara si më sipër. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje të rënda procedurale, të tilla që të mjaftojnë për të mbërritur në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

156. Sa i përket çështjes penale me të pandehur shtetasit E.T dhe A.N, që lidhet me ngjarjen e datës 19.5.2017, ndodhur në fshatin *** (qendra e ish-Komunës Velipojë), ku nga përdorimi i armëve të zjarrit kanë mbetur të dëmtuar/plagosur shtetasit D.T dhe E.T, pas shqyrtimit dhe analizimit të plotë të dosjes, në vlerësim të gjithë të dhënave të evidentuara – ku duket se nga subjekti janë referuar edhe rrethana të rreme në vendim, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me një vendimmarrje të ndikuar nga faktorë të jashtëm dhe jo të marrë në

vlerësim objektiv të rrethanave të ngjarjes, fakteve dhe provave të administruara në fashikullin e kësaj dosjeje penale.

156.1 Në këtë kontekst, në lidhje me këtë dosje, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të paraqesë në mënyrë të përmbledhur dhe shteruese shpjegimet/argumentet e tij mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat e çuan në caktimin e masave të dënimit me burgim – në dukje të ulëta, për të pandehurit e çështjes; (b) të japë shpjegime shteruese dhe të argumentojë mbi përmbushjen/plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe, si rrjedhojë, për disponimin me vendim për pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me burgim për dy të pandehurit e kësaj çështjeje.

157. Më konkretisht, nga verifikimi i dosjes gjyqësore që i përket çështjes penale me të pandehur shtetasit E.T dhe A.N, Komisioni konstaton se:

157.1 Pas hetimeve të kryera, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dërguar për gjykim çështjen në ngarkim të shtetasve A.N dhe E.T, dhe si përfundim ka kërkuar: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, që parashikohet nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, që parashikohet nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri E.T të dënohet përfundimisht me 4 vjet burgim. Aplikimin e uljes së dënimit në masën 1/3-at, në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke e dënuar të pandehurin E.T përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur dhe të vihet në shërbim prove i pandehuri E. T ; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit A.N për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe e municionit”, që parashikohet nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.N për kryerjen e veprës penale “Plagosja e rëndë me dashje”, që parashikohet nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri A.N të dënohet përfundimisht me 6 vjet burgim. Aplikimin e uljes së dënimit në masën 1/3-at, në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke e dënuar të pandehurin A.N përfundimisht me 4 vjet burgim.

157.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përbërje të trupit gjykues të së cilës si gjyqtar i vetëm është subjekti i rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, në datën 20.2.2018, ndër të tjera, ka vendosur⁶⁷: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve luftarake”, vepër kjo e parashikuar si krim nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, vepër kjo e parashikuar si kundërvajtje penale nga neni 84 i Kodit Penal e dënimin e tij me 3 muaj burgim. Bazuar në nenin 55/3 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit E.T me një dënim të vetëm me 4 vjet burgim. Bazuar në nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, nga kjo masë dënimi i ulet 1/3-ta dhe përfundimisht e ka dënuar të pandehurin E.T me 2 vjet e 8 muaj burgim. Bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, caktuar me këtë vendim penal, për pjesën e pavuajtur, duke e vënë të pandehurin E.T në provë, me kusht që gjatë kohës së provës, që është 3 vjet, e fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, të mos kryejë vepër tjetër penale; (2)

⁶⁷ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. *** (***), datë 20.2.2018.

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.N për kryerjen e veprës penale “Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal e dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.N për kryerjen e veprës penale “Plagosja e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal e dënimin e tij me 4 vjet burgim. Bazuar në nenin 55/1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit A.N me 4 vjet e 6 muaj burgim. Bazuar në nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, nga kjo masë dënimi i ulet 1/3-ta dhe përfundimisht e dënon të pandehurin A.N me 3 vjet burgim. Bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur, caktuar me këtë vendim penal, duke e vënë të pandehurin A.N në provë, me kusht që gjatë kohës së provës, që është 3 vjet, e fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, të mos kryejë vepër tjetër penale.

157.3 Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga Prokuroria për në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 19.12.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga prokurori kundër vendimit nr. *** (***), datë 20.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

158. Nga verifikimi i akteve – pjesë e kësaj dosjeje penale, Komisioni vëren se në ankimin e paraqitur Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka parashtruar rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat vërtetohet fajësia e shtetasit A.N , për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 278/1 e 88/1 të Kodit Penal, shprehet se nuk është dakord me vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për sa i përket masës së dënimit të dhënë nga gjykata, ndaj dhe ka bërë ankim, duke parashtruar këto shkaqe: (a) Masa e dënimit e kërkuar nga organi i akuzës i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të parashikuara nga neni 48 i Kodit Penal, prandaj dhe kanë kërkuar dënimin e tij me 6 vjet, ku dispozitat përkatëse parashikojnë 3 – 7 vjet dhe 3 – 10 vjet burgim; (b) Gjykata duhej të mbante parasysh se vepra penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, i pandehuri e ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimit të tij dhe me ndërgjegje e ka mbajtur (supozohet se i referohet armës së zjarrit), dhe aq më tepër e ka përdorur atë duke kryer dhe një vepër tjetër penale, duke dëmtuar rëndë shëndetin dhe janë dy vepra penale që po bëhen çdo ditë dhe më prezent në shoqëri, si dhe të dëmshme për shëndetin e njeriut. (c) Gjykata, pavarësisht argumentimit të bërë lidhur me aplikimin e kushtit, nuk ka arsyetuar drejt, pasi vepra penale e kryer nga i pandehuri është e rrezikshme, duke pasur parasysh pasojat që vijnë nga mbajtja e armës luftarake pa leje në ambiente publike, dhe aq më tepër duke e përdorur atë.

158.1 Për këto arsye, ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit të dhënë ndaj të pandehurit A.N , i akuzuar se ka kryer veprat penale “Plagosja e rëndë me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 88/1 dhe 278/1 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij sipas kërkesës së prokurorisë.

159. Sikurse u evidentua edhe më sipër, ngjarja ka ndodhur në datën 19.5.2017 dhe se për dy nga shtetasit e dyshuar e, në vijim të hetuar e dënuar në lidhje me këtë ngjarje, konkretisht A.N dhe E.T, nuk u bë i mundur arrestimi në flagrancë. Rezulton se në datën 8.1.2018 i pandehuri E.T është vetëdorëzuar në polici, duke bërë të mundur ekzekutimin e vendimit të datës 9.6.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj këtij shtetasi. Ndërsa i pandehuri A.N është vetëdorëzuar në polici në datën 29.1.2018, duke bërë të mundur ekzekutimin e vendimit të datës 9.6.2017, të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Shkodër, për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj këtij shtetasi.

160. Konstatohet se menjëherë pas dorëzimit të shtetasit A.N , Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka zhvilluar 5 seanca gjyqësore dhe pastaj ka shpallur vendimin. Më konkretisht: (i) Dy seancat gjyqësore të datave 30.1.2018 dhe 5.2.2018 kanë rezultuar joproductive, pasi janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit dhe mbrojtësit të një prej të pandehurve; (ii) Në seancën e datës 8.2.2018 është kërkuar dhe pranuar gjykimi i shkurtuar. Gjithashtu, përgjatë kësaj seance, prokurori ka kërkuar kohë që të paraqesë konkluzionet përfundimtare – duke kërkuar shtyrjen e seancës, kërkesë e cila u pranua nga gjykata; (iii) Në seancën e datës 19.2.2018, prokurori ka lexuar konkluzionet përfundimtare – të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim. Avokatët e dy të pandehurve kanë kërkuar 24 orë kohë për konkluzionet e tyre me shkrim; (iv) Në seancën e datës 20.2.2018 (ora e fillimit 13:07) janë lexuar konkluzionet përfundimtare nga avokatët e të pandehurve, si dhe është paraqitur qëndrimi i të pandehurve në lidhje me çështjen. Në fund të seancës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, duke u tërhequr në dhomë këshillimi dhe referuar se vendimi do të shpallet po në datën 20.2.2018, ora 14:00. Vendimi u shpall në datën 20.2.2018, në orën 14:31.

161. Komisioni vëren se në prapësimet e tij lidhur me këtë çështje, subjekti ka argumentuar se dënimet e dhëna prej tij për dy të pandehurit kanë qenë të përafërta me kërkesat e prokurorit. Gjithashtu, ai ka parashtruar se pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për këta dy të pandehur, sipas nenit 59 të Kodit Penal, është bërë në vlerësim të rrethanave lehtësuese – ku krahas evidentimit të rrethanave familjare ka parashtruar se rezulton se ata kanë pranuar fajësinë, kanë shfaqur pendesë dhe kanë rregulluar marrëdhëniet ndërmjet tyre. Por, duket se këtu nuk është marrë parasysh rrezikshmëria e veprave penale të kryera nga dy të pandehurit, si dhe fakti se ata kanë ndenjtur rreth 6 muaj në arrati, duke iu shmangur drejtësisë. Nga ana tjetër, rezulton se menjëherë pas dorëzimit të tyre në kohë rekord është mbyllur procesi/shqyrtimi gjyqësor, në dukje në një bashkëpunim të heshtur mes të pandehurve, organit të akuzës dhe gjykatës.

162. Në vijim të shqyrtimit dhe analizimit të detajuar të vendimit të dhënë nga gjyqtari Tonin Sterkaj në lidhje me këtë çështje, Komisioni vëren se në vlerësimin e rrethanave dhe kushteve, në referim të të cilave ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal (pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurve), ai ka referuar se i pandehuri E.T ka vuajtur rreth 3 muaj burgim, ndërsa i pandehuri A.N ka vuajtur rreth 2 muaj burgim. Ndërkohë, rezulton se deri në momentin e shpalljes së vendimit i pandehuri E.T kishte qëndruar rreth 1 muaj e 12 ditë në paraburgim x 1.5 ditë sipas nenit 57 të Kodit Penal = 63 apo 64 ditë, pra rreth 2 muaj burgim (i konvertuar), ndërsa i pandehuri A.N kishte qëndruar rreth 22 ditë në paraburgim x 1.5 ditë sipas nenit 57 të Kodit Penal = 33 ditë, pra rreth 1 muaj burgim (i konvertuar).

163. Vërehet se në prapësimet e tij subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me këtë konstatim të bërë nga Komisioni, duke pranuar indirekt se ka referuar të dhëna të rreme në vendim, të cilat janë të rëndësishme në kuadër të vendimmarrjes dhe në dukje të qëllimshme për ta mbështetur atë – pasi vështirë se mund të gabohej në këtë rast kur vetëdorëzimi i dy të pandehurve është bërë në janar dhe vendimi është dhënë në shkurt të po të njëjtit viti (2018).

164. Parë në këtë optikë, pa dashur t'i hyjmë themelit të çështjes, duket se masa e dënimit me burgim, e vajtuar nga këta dy të pandehur, është jo proporcionale në raport me veprat penale të kryera nga ana e tyre dhe rrezikshmërisë së lartë shoqërore të cilat paraqesin ato. Kështu, rezulton se një i dënuar për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 3 deri në 10 vjet burgim, si dhe për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim, përfundimisht ka qëndruar vetëm 22 ditë në paraburgim. Ndërsa, një i dënuar për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, e cila përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 1 vit burgim, si dhe për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim, përfundimisht ka qëndruar vetëm 1 muaj e 12 ditë në paraburgim.

165. Si konkluzion, pas shqyrtimit dhe analizimit në tërësi të kësaj çështjeje – në vlerësim të të gjitha të dhënave të evidentuara në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – trupi gjykues arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me një vendimmarrje të marrë jo në vlerësim objektiv të rrethanave të ngjarjes, fakteve dhe provave të administruara në fashikullin e kësaj dosjeje penale, kjo nisur edhe nga rrezikshmëria e lartë shoqërore që paraqesin veprat penale për të cilat janë hetuar dhe dënuar autorët përkatës.

166. Gjithsesi, për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi, si dhe mbi vendimmarrjen e bërë nga subjekti për çështjen gjyqësore penale me të pandehur shtetasit A.N dhe E.T – të administruar bazuar në informacionet/sinjalizimet e përfituara nga institucionet e verifikimit – nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por se gjithsesi konkludon që këto gjetje t'i vlerësojë në tërësi me gjetjet e tjera në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në raport me pasojat që kanë sjellë tek publiku në drejtim të cenimit të besimit të sistemi i drejtësisë.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

167. Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, pasi: (i) evidentohen mospërputhje/deklarime kontradiktore në lidhje me dy hua të marra në vitin 2009 dhe destinacionin e tyre; (ii) rezulton se ka përfutuar tokë bujqësore në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën” si dhe disponon një shtëpi banimi në fshat – pa provuar ligjërisht mënyrën e fitimit të pronësisë mbi të; (iii) evidentohen raste të përsëritura për vonesa në zbardhjen e vendimeve dhe zgjatjes së gjykimit tej afateve standarde, të cilat kanë cenuar garancitë për një proces të rregullt ligjor; (iv) për një rast është çmuar se ka kryer vendimmarrje jo në vlerësim objektiv të rrethanave të ngjarjes, fakteve dhe provave të administruara në fashikullin gjyqësor.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se **subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë**, pasi rezultoi se ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të saj, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Gjithashtu, në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues arriti në përfundimin se ai ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Tonin Sterkaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 4.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ

Kryesuese

Pamela QIRKO

Relatore

Xhensila PINE

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Amela Idrizi

ANEKSI NR. 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Tabela Përmbledhëse e Analizës Financiare për periudhën 01.08.1993 - 31.12.2003 dhe vitet 2004 -2016 (Vlerat në Lek)	1993-31.12.2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	7,016,785	1,273,002	88,245	-117,587	37,443	53,340	2,337,608	34,275	-20,649	558,376	541,545	-426,263	-291,546	133,347
Tokë truall në qytetin e Shkodrës, me sipërfaqe prej 240 m2.	500,000													
Shtëpi banimi 3-katëshe me sipërfaqe prej 123.3 m2 kat përdhe; 128.55 m2 kati I parë dhe 142.66 m2 kati I dytë (394.5 m2 total). Lagja *** qyteti Shkodër.	6,516,785	1,273,002					110,387				18,000			
Automjeti i markës *** me targë SH*** / AA***, blerë nga subjekti i rivlerësimit në Gjermani në datë 25.03.2009.							2,188,365							
Automjeti i markës *** me targë AA***, blerë nga bashkëshortja dhe nga S.R në datë 11.07.2012.										441,600				
Ndryshim likuiditeti	0	0	88,245	-117,587	37,443	53,340	38,856	34,275	-20,649	116,776	523,545	-426,263	-291,546	133,347
B) Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hua nga shtetasi Gj.M														
Hua nga shtetasi A. N.S														
C) Pasuri neto (A-B)	7,016,785	1,273,002	88,245	-117,587	37,443	53,340	2,337,608	34,275	-20,649	558,376	541,545	-426,263	-291,546	133,347
D) Të ardhura	4,203,111	874,489	808,101	827,096	831,524	823,726	1,073,015	1,027,623	1,033,466	1,256,081	1,367,300	1,342,907	1,382,626	1,434,368
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	3,258,111	874,489	808,101	827,096	831,524	823,726	1,073,015	1,027,623	1,033,466	1,250,244	1,360,041	1,340,418	1,382,626	1,434,368
Të ardhura nga interesat e depozitës L.S										5,837	7,259	2,489		
Të ardhura nga dhurimi i shtetasit A.S	756,000													
Të ardhura nga dhurimi i shtetasit A .S (B)														
Të ardhura nga dhurimi i shtetasit N.L														
Të ardhura nga punwsimi para marrjes së detyrës si gjyqtar	189,000													
E) Shpenzime	3,050,375	549,320	681,839	799,833	889,500	965,155	1,118,668	1,598,785	1,487,981	1,525,154	1,636,124	2,289,492	2,873,950	1,953,242
Shpenzime minimale jetike	3,014,375	469,320	547,785	547,785	683,100	683,100	683,100	614,790	409,860	423,072	387,816	439,996	448,552	470,184
Shpenzime qiraje	36,000													
Shpenzime për shlyerjen e huasë ndaj shtetasit A.S													800,000	
Shpenzime arredimi / mobilimi	0	80,000	80,000	90,000	80,000	80,000	80,000	140,000	80,000	80,000	80,000	96,000	96,500	110,000
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	0	0	12,254	38,348	0	64,055	241,419	231,813	282,132	285,029	250,976	393,709	360,643	401,752
Shpenzime qëndrimi / fjetje / ushqimi në Itali K.S								253,328	252,398	254,989	255,883	255,701	251,211	246,868
Shpenzime qëndrimi / fjetje / ushqimi në Itali K.S								253,328	252,398	254,989	255,883	255,701	251,211	246,868
Shpenzime qëndrimi / fjetje / ushqimi në Itali K.S											220,585	662,335	436,213	246,868
Shpenzime vetëm për tarifa shkollimi / brenda / jashtë vendit K.S (09.03.1991)	0		41,800	44,750	44,750	51,000	21,399	24,163	75,097	81,038	78,711	78,935	77,687	76,901
Shpenzime vetëm për tarifa shkollimi / brenda / jashtë vendit K.S (11.06.1992)	0			44,750	44,750	51,000	52,250	24,163	75,097	81,038	78,711	78,935	77,687	76,901
Shpenzime vetëm për tarifa shkollimi / brenda / jashtë vendit K.S (25.07.1995)	0			34,200	36,900	36,000	40,500	57,200	61,000	65,000	27,558	28,180	74,246	76,901
Balanc e fondeve (D-C-E)	-5,864,049	-947,833	38,017	144,850	-95,419	-194,769	-2,383,261	-605,437	-433,866	-827,449	-810,369	-520,322	-1,199,778	-652,221